



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31/2023 regjistër (JR)
Datë 17.07.2023

Nr. 77 i vendimit
Datë 03.11.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 03.11.2025, ditën e hënë, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 31/2023 (JR), datë 17.07.2023, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 652, datë 28.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni D i Aneksit të Kushtetutës; nenet 4, 18, 42, 116, 122, 131, pika “f” e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të KEDNj-së; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, nr. 30, datë 13.02.2023, mbi juridiksionin e KPA-së; vendimi i GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë” mbi juridiksionin e KPA-së; nenet 32, 33, 47, 49, 51, 52, 57, 59, 61, 63 dhe 66, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse si vijon:

2.1 Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar: *a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar² (në vijim “DSIK”), në përfundim të kontrollit të figurës ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Armand S. Gurakuqi.*

2.3 Këshilli i Lartë i Prokurorisë³ (në vijim “KLP”), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 652, datë 28.04.2023, Komisioni ka vendosur: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*. Ky vendim është marrë bazuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si vijon:

a. Në lidhje me kriterin e pasurisë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 31.12.2018.

² Raporti i DSIK-së nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 17.06.2022.

³ Raporti i KLP-së nr. {***} prot., datë 25.10.2021.

kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germës “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, ka arritur në nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, çmon se, duke parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve apo hetime të paplota apo të pakryera nga subjekti i rivlerësimit Armand Gurakuqi, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

*d. Gjithashtu, çmon se, në një vlerësim të përgjithshëm dhe tërësor të dinamikës, rrethanave, deklarimeve, shpjegimeve dhe dokumenteve të administruara në lidhje me marrëdhëniet juridiko-financiare të krijuara nga personi i lidhur (bashkëshortja) me z. Sh. dhe me shoqërinë “{***}” ShPK, përpos investimeve në mënyrë të përsëritur, duke përdorur mjete monetare të huazuara në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti, vërehen një sërë faktesh që, të ndërthurura mes tyre, krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar nga Kolegji: (i) shpalljen si antikushtetues të vendimit nr. 652, datë 28.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; (ii) ndryshimin e vendimit duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale për shkelje të parimeve kushtetuese dhe të KEDNj-së, dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat, në tërësinë e tyre, kanë të bëjnë më interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave.
5. Shkaqet e ankimit, që i përkasin aspekteve procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

5.1 Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante parimin e procesit të rregullt ligjor, duke i cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën e aksesit në gjykatë, të drejtën efektive për t’u dëgjuar, si dhe ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe detyrimin për arsyetimin e vendimit dhe bazueshmërinë e tij në prova.

5.2 Komisioni ka cenuar institutin e “barrës së provës” të parashikuar nga neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet e mungesës totale të provave, duke e shndërruar procesin në një procedurë inkuizicioni, të ndërtuar mbi hamendësime dhe paragjykime.

5.3 Komisioni ka cenuar parimin e sigurisë juridike pasi ka mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta me parashikimet kushtetuese dhe ligjore për rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimit, e njëkohësisht, me standardet e vendosura nga KPA-ja lidhur me këto parashikime.

5.4 Komisioni ka cenuar të drejtën për respektim të jetës private dhe familjare, në shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe të standardeve të vendosura nga GjEDNJ-ja, pasi shkarkimi i tij është marrë në kushtet kur është provuar plotësisht integriteti dhe kompetenca e tij profesionale.

5.5 Komisioni, përmes vendimit objekt ankimi, ka shkelur parimin e hierarkisë së normave juridike të parashikuar në nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës, dhe të sigurisë juridike, pasi ka aplikuar dhe interpretuar në kundërshtim me nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, nenet 61, pikat 3 dhe 5, dhe nenin 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 84/2016.

5.6 Për shkak të shkeljes së parimeve të sipërcituara, vendimi objekt shqyrtimi duhet të shpallet antikushtetues nga Kolegji.

6. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

6.1 Në lidhje me “Apartament banimi me sipërfaqe 92 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”, konkluzioni i Komisionit është në kundërshtim flagrant me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 31, 32, pika 4 dhe 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe standardet e Kolegjit e Komisionit, dhe është marrë pa analizuar provat e paraqitura nga ana e tij dhe të administruara nga Komisioni.

6.2 Në lidhje me “Apartament banimi me sipërfaqe 61 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”, në vlerën 4.600.000 lekë”, konkluzioni i Komisionit është i njëanshëm, i paligjshëm dhe i marrë pa analizuar, qoftë edhe formalisht, provat e administruara.

6.3 Lidhur me vlerësimin e marrëdhënies së investimit të bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK, dhe burimin e saj që është huaja në vlerën 75.000 euro e marrë nga shtetasi F. Sh., Komisioni ka vepruar në shkelje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 31, 32, pika 4; 33, pika 5; neni 61, pika 5 dhe me standardet e vendosura nga Kolegji dhe Komisioni.

6.4 Në lidhje me analizën financiare të vitit 2006 dhe 2010, rezultati i analizës financiare është i gabuar, pasi Komisioni nuk ka marrë për bazë asnjë nga provat e administruara.

7. Pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit, paraqiti parashtrime⁴ shoqëruar me akte shkresore, në të cilat i kërkon Kolegjit: (i) marrjen në cilësinë e provës së re të provave origjinale ose të njësuara; (ii) shpalljen antikushtetues të vendimit nr. 652, datë 28.04.2023, të Komisionit; (iii) ndryshimin e vendimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

⁴ Regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 25.09.2025.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 652, datë 28.04.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankim, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Për të konkluduar mbi formën e gjykimin të çështjes, si dhe për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të kryer në Komision, sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, trupi gjykues vlerësoi të trajtojë në fillim shkaqet procedurale të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe të shqyrtojë aktet shkresore të paraqitura me parashtrimet përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi.
12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante parimin e procesit të rregullt ligjor, duke i cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, të drejtën efektive për t’u dëgjuar, si dhe ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe detyrimin për arsyetimin e vendimit dhe bazueshmërinë e tij në prova, pasi pavarësisht se nuk ka marrë asnjë vendim për përjashtim të tyre, nuk ka marrë në shqyrtim e as nuk ka konsideruar një numër të konsiderueshëm provash. Shkelja e këtyre parimeve dhe të drejtave shfaqet gjatë gjithë analizës*

së kriterit të pasurisë dhe në përfundimet e arritura lidhur me: (i) këstin prej 20.000 eurosh të paguar më datë 31.05.2025 për blerjen e banesës në rrugën “{***}”, Tiranë; (ii) gjendjen e cash-it më datë 31.12.2005; (iii) gjendjen e cash-it më datë 31.12.2006; (iv) apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë; (v) investimin e bashkëshortes me shoqërinë “{***}” dhe huan e përdorur për këtë qëllim.

12.1 Në vlerësim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i veprimtarisë procedurale së zhvilluar në Komision, nga nisja e hetimit administrativ më datë 15.06.2020, deri në zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 26.04.2023, trupit gjykues i rezulton që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime e akte shkresore në përgjigje të 7 (shtatë) pyetësorëve⁵ të drejtuar nga Komisioni, fakt që dëshmon për një bashkëveprim të ndërsjellë mes tij dhe Komisionit. Pasi i është garantuar e drejta e njohjes me aktet e administruara gjatë hetimit paraprak, sikurse konfirmuar prej tij⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësime⁷ dhe akte shkresore në përgjigje të barrës së provës të dërguar nga Komisioni në përfundim të hetimit administrativ, si dhe është dëgjuar në seancë dëgjimore, në të cilën nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime apo kërkesa për njëanshmëri, paracaktim apo moskryerje të debatit në procesin e tij të rivlerësimit. Nga aktet, gjithashtu, nuk rezulton që Komisioni të ketë refuzuar ndonjë provë të paraqitur nga subjekti, që do ta ngarkonte atë me detyrimin për të dalë me vendim të arsyetuar për shkaqet e refuzimit sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Sa i takon pretendimit për mungesë të arsytimit të vendimit, trupi gjykues vëren se vendimi i Komisionit përmbush kriteret e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, si në aspektin formal, ashtu edhe në atë përmbajtësor. Konkretisht, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren fillimisht se ai përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe atë urdhëruese, dhe për secilën pasuri të hetuar është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur hetimi i kryer, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, si dhe fakti nëse shpjegimet apo provat e sjella prej tij kanë mundur ose jo të ndryshojnë barrën e provës. Në lidhje me pretendimin për mungesë të analizimit të provave, trupi gjykues sjell në vëmendje se, fakti që subjekti i konsideron pretendimet e tij të mbështetura në provat e sjella, nuk nënkupton detyrim të Komisionit për të pasur optikë të njëjtë me të. Komisioni ka diskrecion të vlerësojë në mënyrë të pavarur, harmonike e në tërësi provat, dokumentet dhe indiciet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, e nën dritën e pikës 4, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016⁸

⁵ i. Përgjigjet e pyetësorit standard regjistruar në Komision me nr. 01.02.2021; ii. përgjigjet e pyetësorit nr.2, regjistruar me nr. {***} prot., datë 18.10.2022; iii. përgjigjet e pyetësorit nr. 3, regjistruar me nr. {***} prot., datë 03.11.2022; iv. përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar me postë elektronike më datë 02.12.2022; v. përgjigjet e pyetësorit nr. 5, dërguar me postë elektronike më datë 05.01.2023; vi. përgjigjet e pyetësorit nr. 6, dërguar me postë elektronike më datë 02.02.2023; vii. përgjigjet e pyetësorit nr.7, regjistruar me nr. {***} prot., datë 03.03.2023.

⁶ Me deklaratën e datës 18.04.2023, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar njohjen dhe marrjen e të gjithë dokumentacionit sipas kërkesës së tij.

⁷ Shpjegime mbi rezultatet e hetimit, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.04.2023.

⁸ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: [...] Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].

apo edhe nenit 81 të Kodit të Procedurës Administrative⁹, krijon bindjen e tij të brendshme për një situatë faktike. Optika e ndryshme e vlerësimit nga Komisioni, nuk nënkupton mungesë të analizimit dhe vlerësimit të tyre, dhe as subjektivizëm, por një analizë të ndryshme që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimi i subjektit. Edhe nëse do të prezumohej e provuar që konkluzionet e Komisionit janë të pabazuara në prova, siç pretendon subjekti, për sa vendimi i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, të gjithë pretendimet dhe kërkimet e tij në këtë drejtim do të zgjidhen nëpërmjet vendimit përfundimtar të Kolegjit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit procesit të rregullt ligjor, në drejtim të sa më lart, vlerësohen të pabazuara.

13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi ka mbajtur qëndrime diametralisht të kundërt me parashikimet kushtetuese dhe ligjore për rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimit, e njëkohësisht me standardet e vendosura nga Kolegji dhe Komisioni lidhur me këto parashikime, duke iu referuar konkretisht: (i) mosklasifikimit si pasaktësi në deklaratat periodike të viteve 2004 dhe 2005 të të ardhurave dhe kursimeve të nënës dhe bashkëshortes së tij, ndërkohë që referuar jurisprudencës, këto institucione, në rastet e pasaktësive të paraqitura në deklaratat periodike, nuk kanë klasifikuar subjektin në kushtet e shkëljes disiplinore; (ii) vlerësimit të kursimeve të nënës së tij në kundërshtim me qëndrimet dhe standardet e vendosura, sipas të cilave nuk mund të deklarohen likuiditete që kanë qenë në administrim të prindërve dhe të familjes së subjektit të rivlerësimit.*

13.1 Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell fillimisht në vëmendje se procesi kushtetues i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rregullat e posaçme të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, roli dhe kompetencat që ky ligj i njej Kolegjit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, përbëjnë garanci të plotë për të përmbushur qëllimin dhe objektin e ligjit. Në zbatim të këtyre parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit¹⁰, trupi gjykues vlerëson se pretendimi për mbajtje të standardeve të ndryshme nga Komisioni në situata të ngjashme, nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për cenimin e parimit të sigurisë juridike e për pasojë shkak procedural për cenimin e vendimit objekt shqyrtimi. Kontrolli i vendimeve të Komisionit nga Kolegji kryhet vetëm nëpërmjet ankimit të subjekteve të rivlerësimit, në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Në rastin konkret, situatat e adresuara nga subjekti i rivlerësimit si më lart, iu nënshtroan kontrollit të Kolegjit përmes analizimit të shkakut të ankimit që kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë “*Apartament banimi, me sipërfaqe 92 m²*”, në rrugën “{***}”, Tiranë.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni ka cenuar të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, në shkëlje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe të standardeve të vendosura nga GjEDNJ-ja, pasi shkarkimi i tij është marrë në kushtet kur është provuar plotësisht integriteti*

⁹ Neni 81 i K. Pr. Administrative parashikon: [...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ [...].

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit nr. 20/2021(JR), nr. 19/2022 (JR), nr. 16/2022 (JR) dhe nr. 6/2024 (JR).

dhe kompetenca e tij profesionale. Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i referohet jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”,¹¹ vendim në të cilin GjEDNj-ja, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 8 të KEDNj-së, ka theksuar se *shkarkimi nga detyra kryesisht i gjyqtarëve ose prokurorëve me status jetëgjatë në sistem është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që mund të merret ndaj një individi. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit.*

14.1 Sikurse elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, por tashmë konfirmuar edhe nga kontrolli i kryer nga GjEDNj-ja nëpërmjet çështjes “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, masa disiplinore e shkarkimit parashikuar nga ligji shqiptar, nuk është disproporcionale dhe as në shkelje të parimeve të nenit 8 të Konventës¹². Ndonëse është e vërtetë që subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në drejtim të aftësive profesionale, situata të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, masa e shkarkimit për të është marrë bazuar në po këtë dispozitë ligjore, pikat 3 dhe 5 të saj. Konkretisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij e personave të lidhur me të, si dhe ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, kushte që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Secila prej këtyre dy situatave mund të çojë në mënyrë autonome në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në rrethanat konkrete, në kriterin pasuror të kontrolluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar *me mungesë burimesh financiare* të ligjshme për krijimin e pasurive, sikurse edhe me *cenim të besimit të publikut*. Në këto kushte, masa disiplinore e subjektit ka qenë rrjedhojë logjike e vlerësimit të kryer nga Komisioni. Nga ana tjetër, GjEDNj-ja në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, vlerëson se, për sa ka të bëjë me proporcionalitetin midis shkarkimit të kërkuarës dhe qëllimeve legjitime të ndjekura, shkarkimi nga detyra – kryesisht i gjyqtarëve ose i prokurorëve me status jetëgjatë në sistem – është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që mund të merret ndaj një individi. Proporcionaliteti është një parim themelor kushtetues, i cili ka për qëllim që masat ndaluese të jenë të përshtatshme dhe të nevojshme, në mënyrë që pasojat e shkaktuara të mos jenë në disproporcion me qëllimin që synohet të arrihet nëpërmjet këtyre masave. Thënë kjo, referuar GjEDNj-së, që masa disiplinore të mos ndikojë negativisht në jetën private të subjektit, nga gjykata rast pas rasti thirret për zbatim ky parim, në varësi të rrethanave specifike të çështjes e cila është objekt shqyrtimi dhe qëllimit që synohet të arrihet. Në kushtet kur, nga analizimi i shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra çmohet se ka qenë proporcionale, e në zbatim të drejtë të normës së ligjit nr. 84/2016, dhe ky i fundit ka kaluar kontrollin e kushtetutshmërisë dhe atë të përputhshmërisë me garancitë e sanksionuara nga KEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit, për cenim të së drejtës për jetë private, është i pabazuar.

¹¹ Në këtë vendim, GjEDNj-ja, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 8 të KEDNj-së, ka theksuar se *shkarkimi nga detyra kryesisht i gjyqtarëve ose prokurorëve me status jetëgjatë në sistem është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që mund të merret ndaj një individi. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit.*

¹² Shih paragrafët 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”.

15. Komisioni, përmes vendimit objekt ankimi, ka shkelur parimin e hierarkisë së normave juridike të parashikuar në nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës, dhe parimin e sigurisë juridike, pasi ka aplikuar dhe interpretuar nenet 61, pikat 3 dhe 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, në kundërshtim me nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës. Sipas subjektit të rivlerësimit ai nuk ndodhet në kushtet e “dyfishit të të ardhurave” sepse diferenca negative e nxjerrë prej Komisionit në vlerën prej 2.693.552 lekësh, është rreth shtatë herë më e vogël se “dyfishi i të ardhurave” të ligjshme të familjes së tij; nuk ndodhet në kushtet e “deklarimit të pamjaftueshëm” sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi aplikimi i kësaj dispozite i referohet të dhënave të dy kriterëve, atij të pasurisë dhe figurës; nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të rremë sipas nenit 33, pika 5 shkronja “ç”, pasi deklarimet e tij në lidhje me apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, konkretisht me sipërfaqen, çmimin, kohën e blerjes apo kontratën e blerjes, kanë qenë tërësisht të sakta.

15.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar jurisprudencës¹³ së Kolegjit, sipas së cilës në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, respektivisht mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga kjo dispozitë, nëse deklarimi i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, vlerësimi për deklarim të pamjaftueshëm për subjektin e rivlerësimit bazohet në mungesën e të ardhurave nga burime të ligjshme, situatë kjo që cenon nivelin e besueshmërisë së kriterit të kontrollit të pasurisë, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa cilado nga situatat e parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport apo të ndërlidhura me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Veç kësaj, masa disiplinore dhënë subjektit mbështetet edhe në konkluzionin për cenim të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur nga analizimi i shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, lidhur me kundërshtimin e konkluzioneve të Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në krijimin e pasurive në pronësi të tij dhe personit të lidhur, si dhe cenimin e besimit të publikut, u gjet i drejtë interpretimi dhe aplikimi i këtyre dispozitave, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenimin e parimit të hierarkisë së normave.

16. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se për shkak të shkeljes së parimeve të sipërcituara, vendimi objekt shqyrtimi duhet të shpallet antikushtetues nga Kolegji¹⁴, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit kalimtar, me natyrë *sui generis*, i cili rregullohet sipas nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, mund të përfundojë vetëm

¹³ Vendimi nr. 33, datë 29.07.2022, i Kolegjit, paragrafi 19 etj.

¹⁴ Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka referuar disa vendime të Gjykatës Kushtetuese: vendimi nr. 6, datë 16.02.2015, mbi të drejtën e aksesit në gjykatë; vendimi nr. 3, datë 23.01.2014, mbi barazinë e armëve; vendimi nr. 2/2017, mbi bazueshmërinë e vendimit në prova; vendimi nr. 17, datë 24.03.2014, mbi bazueshmërinë e vendimit në prova dhe arsyetimin e vendimit, si dhe jurisprudencën e GjEDNj-së: çështja “Carmel Saliba kundër Maltës”, mbi bazueshmërinë e vendimit në prova; çështja “Donadze kundër Gjeorgjisë”, mbi dëgjimin efektiv nga Gjykata; çështja “Kraska kundër Zvicrës”, mbi shqyrtimin e pretendimeve dhe provave të palëve; çështja “Ramos Nunes de Carvalho e Sa kundër Portugalisë”, e lidhur me caktimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarit; çështja “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, mbi barazinë e armëve dhe dëgjimin efektiv të palëve.

nëpërmjet dy alternativave vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit, konfirmimit në detyrë ose shkarkimit nga detyra të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi. Ndërsa referuar parashikimeve të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, vendimmarrjet e Kolegjit i nënshtrohen kontrollit nga GjEDNj-ja, mbi bazën e ankimit të subjekteve të rivlerësimit lidhur me pretendime mbi cenimin e të drejtave dhe lirive të tyre të mbrojtura sipas KEDNj-së dhe protokolleve të saj.

17. Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka cenuar institutin e "barrës së provës", të parashikuar nga neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet e mungesës totale të provave, duke e shndërruar procesin në një procedurë inkuizicioni, të ndërtuar mbi hamendësime dhe paragjykime, duke iu referuar konkretisht kalimit të barrës së provës lidhur me: (i) kontratën e huas së datës 21.02.2009 mes subjektit të rivlerësimit dhe vjehrrës së tij, znj. H. H.; (ii) marrëdhënien e investimit dhe të huas së vitit 2012, të lidhura përkatësisht mes bashkëshortes së tij dhe shtetasve Z. Z. e F. Sh.*

17.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, fillimisht në drejtim të marrëdhënies së huas së vitit 2009, mes subjektit të rivlerësimit dhe znj. H. H., trupi gjykues vëren se Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 30, 32, pika 4, dhe 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer gjatë hetimit administrativ verifikime në drejtim të huas në vlerën 2.000.000 lekë të marrë nga subjekti i rivlerësimit prej znj. H., të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë "*Apartament banimi*" në rrugën "{***}", Tiranë, dhe në përfundim të hetimit administrativ, në aplikim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, me njoftimin e rezultateve të hetimit, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës¹⁵ mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme të huadhënëses për të dhënë këtë hua, si dhe i ka bërë të njohur hetimin e kryer dhe provat e administruara deri në atë moment¹⁶. Në vlerësimin përfundimtar në vendim, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë hua në mesin e të ardhurave të ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie¹⁷, duke e përlllogaritur në analizën financiare në vlerën 0 (zero) lekë.¹⁸ Trupi gjykues, në kushtet kur pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenimin e institutit të barrës së provës, i atribuohet mungesës totale të provave, pa rënë në përsëritje me sa më lart, vlerëson se optika e ndryshme e vlerësimit nga Komisioni, nuk nënkupton mungesë të analizimit dhe vlerësimit të provave dhe as subjektivizëm, në drejtim të kalimit të barrës së provës, por një analizë të ndryshme që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimi i subjektit. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerësoi se ky qëndrim ndryshe, nuk e bën Komisionin as subjektiv dhe as të njëanshëm. Pasi e analizoi këtë pretendim edhe në kuadër të shkakut të ankimit që kundërshton konkluzionin përfundimtar të Komisionit lidhur me apartamentin në rrugën "{***}", Tiranë, pasqyruar në paragrafin 32 të këtij vendimi, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e tij për cenimin e institutit të barrës së provës bazuar në peshën që Komisioni u ka dhënë provave të ndryshme.

¹⁵ Për këtë çështje, subjektit i ka kaluar barra e provës: *Duket se vjehrra e subjektit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për dhënien e huas në shumën 2.000.000 lekë, subjektit të rivlerësimit. [...]*

¹⁶ Paragrafi 2.1.1 i rezultateve të hetimit.

¹⁷ Shih paragrafin 75 të vendimit të Komisionit.

¹⁸ Shih analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, në faqen 41 të vendimit të Komisionit.

17.2 Në vijim të analizimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren gjithashtu se, në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit edhe barrën e provës¹⁹ lidhur me marrëdhënien e huas dhe atë të bashkëpunimit, të vitit 2012, mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe respektivisht shtetasve F. Sh., huadhënës, dhe Z. Z., ortak i shoqërisë investitore “{***}” ShPK, të deklaruara në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës së personit të lidhur, znj. G. G., pjesë e deklaratës së pasurisë *vetting*, duke i bërë të njohura edhe provat e administruara deri në atë moment.²⁰ Në qëndrimin e tij përfundimtar në vendim, Komisioni ka vlerësuar se kjo marrëdhënie interesi është krijuar në mënyrë artificiale, për të evituar verifikimin e burimeve reale, duke tentuar fshehjen e gjurmëve të investimit të vërtetë. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe i ka atribuar subjektit pasojën ligjore të parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me rrjedhje shkarkimin nga detyra. Teksa mban këtë qëndrim, trupi gjykues vëren se, në analizën financiare të vendimit për periudhën 2003 – 2016²¹, Komisioni ka përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme të vitit 2012, huan e marrë nga shtetasi F. Sh., pra e ka konsideruar atë si burim të ligjshëm për investimin e kryer po në këtë vit nga bashkëshortja e tij në bashkëpunim me shtetasin Z. Z. Gjendur në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se ishte e nevojshme që çështja të shqyrtohej në seancë gjyqësore publike me prezencën e subjektit të rivlerësimit, me qëllim konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike lidhur me këto marrëdhënie. Trupi gjykues vërejtë se paqartësia apo paplotësia rreth kësaj situatë faktike vinte si për shkak të nevojës për të qartësuar aspektin kontradiktor në vendimin e Komisionit, ashtu dhe për të adresuar çështje/pyetje më specifike ndaj subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë marrëdhënie. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me vendim të ndërmjetëm të datës 02.10.2025, vendosi vijimin e gjykimit të kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, për konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike lidhur me marrëdhënien e huas mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe z. F. Sh., si dhe marrëdhënien e bashkëpunimit mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe z. Z. Z., ortak pranë shoqërisë investitore “{***}” ShPK.

18. Në seancën gjyqësore publike të datës 27.10.2025, trupi gjykues vendosi: (i) të mos administrojë në cilësinë e provës aktet²² e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 27.10.2025, pasi nuk kanë formën e duhur ligjore; (ii) të mos administrojë në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e datës 25.09.2025, përveç akteve që janë të aksesueshme nga burime të hapura nga Kolegji në sistemin

¹⁹ Për këtë çështje, subjektit i ka kaluar barra e provës: Duket se nuk ka logjikë ekonomike në marrjen e një huaje prej 75.000 eurosh për të kryer një investim në të njëjtën vlerë, ndërkohë që nuk është i qartë shkaku i marrjes së tyre, pa interes nga një person me biznes, - për t'i investuar tek një tjetër biznes, për zhvillimin e një projekti ndërtues, - e për rrjedhje kjo huamarrje duket një veprim fiktiv. -- Për më tepër, vërehet se kjo mënyrë investimi – duke përdorur mjete monetare të huazuara, në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti – është hasur në mënyrë të përsëritur, sikurse është evidentuar edhe në pasuritë e tjera të analizuara më lart, e për rrjedhje, ngrihen dyshime mbi vërtetësinë e huamarrjes në fjalë.

²⁰ Paragrafi 5 i rezultateve të hetimit.

²¹ Shih analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, në faqen 41 të vendimit të Komisionit.

²² Printime komunikimesh në WhatsApp dhe deklaratë e interesave privatë periodikë vjetorë 2021, e pashoqëruar me vërtetimin e dorëzimit nga institucioni përgjegjës.

elektronik të QKB-së,²³ pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 dhe nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si dhe nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, bazuar në analizën si vijon:

(i) Lidhur me aktet e paraqitura²⁴ nga subjekti i rivlerësimit në funksion të shkakut të ankimit të trajtuar në paragrafin 44 të këtij vendimi, me qëllim vërtetimin e ushtrimit të aktivitetit të rrobaqepësisë nga znj. H. H., trupi gjykues konstaton se këto akte (përveç akteve të paraqitura nga shoqata “{***}”, Durrës, dhe 7 (shtatë) fotografitë e datës 13.09.2025, të cilat japin informacion për ngjarje të vitit 2025, pra përtej periudhës objekt shqyrtimi që është deri në vitin 2009 kur u dha huaja nga znj. H. H.) kërkojnë të provojnë fakte/ngjarje të ndodhura përpara dhënies së vendimit të Komisionit, dhe që janë evidentuar gjatë hetimit administrativ. Paraqitja për herë të parë e këtyre akteve me parashtrimet në Kolegj, në kushtet kur nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është provuar pamundësia e paraqitjes së tyre gjatë hetimit administrativ në Komision apo me ankimin, i bën ato të papranueshme në cilësinë e provës së re, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Edhe në eventualitetin e tejkalimit të këtij kriteri formal, trupi gjykues, nga analizimi i përmbajtjes së këtyre akteve, e vlerëson marrjen e tyre në cilësinë e provës, të panevojshme edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, bazuar në analizën sa vijon: (i) Deklaratat noteriale të hartuara në vitin 2025, përmes të cilave subjekti kërkon të provojë ushtrimin e profesionit të rrobaqepësisë së znj. H. H., ndonëse nuk janë të pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, ato nuk mund të kenë fuqi provuese në këtë proces, pasi rezultojnë të jenë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, dhe për këtë shkak, si dhe nga përmbajtja e tyre, krijojnë bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. (ii) Shkresa kthim përgjigje e Bashkisë Peqin, po ashtu e iniciuar pas marrjes së vendimit të Komisionit, sipas së cilës informohet se në këtë institucion nuk administrohen të dhëna mbi individët që kanë tregtuar në periudhën 1995 – 2009, jo vetëm që nuk provon ushtrimin e aktivitetit të rrobaqepësisë së znj. H., por në kushtet kur daton pas shpalljes së vendimit të Komisionit, dështon të provojë pamundësinë objektive të marrjes së dokumenteve, parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. (iii) dokumentacioni i sigurimeve shoqërore, ndonëse tregon për gjurmë të hershme të ushtrimit të profesionit të rrobaqepësisë nga znj. H., nuk provon të ardhura konkrete të përfituara nga asistenca apo nga

²³ Ekstrakte historike të regjistrit tregtar të shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, shoqëruar me aktet: i. urdhër nr. {***} prot., datë 24.04.2023, “Për vendosjen e sekuestros konservative” i zyrës së përmbartimit privat “{***}” ShPK; ii. kërkesë nr. {***} prot., datë 25.11.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; iii. urdhër nr. {***} prot., datë 23.06.2020, “Për vendosjen e sekuestros konservative”, i shoqërisë “{***}” ShPK; iv. urdhër nr. {***} prot., datë 06.04.2022, “Për vënien e sekuestros konservative” i shoqërisë “{***}” ShPK; v. urdhër nr. {***} prot., datë 10.03.2020, “Vendosje sekuestro konservative” i zyrës së përmbartimit privat “{***}” ShPK.

²⁴ Deklarata noteriale të vitit 2025 të shtetaseve B. A., A. T., E. Sh. dhe A. D.; -- shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 22.09.2025, e Bashkisë Peqin; -- vërtetim, datë 18.09.2025, i shoqatës “{***}” Durrës, shoqëruar me printime të dy fotove të publikuara në rrjetin Facebook mbi aktivitete të kësaj shoqate; -- 7 (shtatë) fotografi të datës 13.09.2025, me pamje nga aktivitet rrobaqepësie; -- dokumente mbi të ardhurat nga pensioni të H. H. me vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 22.09.2025: i. Vendim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, për përfshirjen në llogaritjen e pensionit të periudhës së asistencës; ii. vendim nr. {***}, datë 09.01.2013, për rishqyrtim pensioni; iii. librezë pune; iv. shkresë nr. {***} prot., datë 20.08.2012 e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan për dërgim akt verifikimi të vjetërsisë në punë; -- librezë të energjisë elektrike për kontratë me nr. {***}, në Durrës, në emër të shtetasit R. M., 2013 – 2025, me vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 19.09.2025 dhe nr. {***} rep., datë 24.09.2025.

ushtrimi i këtij profesioni përpara vitit 2009. (iv) Librezat e energjisë elektrike me numër kontrate {***} në emër të shtetasit R. M., nuk provojnë marrëdhënien e znj. H. me ambientin në të cilin është lidhur kontrata e energjisë elektrike, e aq më pak ushtrimin e ndonjë aktiviteti.

(ii) Lidhur me aktet e paraqitura²⁵ nga subjekti i rivlerësimit në funksion të shkakut të ankimit të trajtuar në paragrafin 58 të këtij vendimi, në drejtim të vërtetësisë së marrëdhënies së huas së vitit 2012, mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit F. Sh., trupi gjykues konstaton se këto akte (pavarësisht datës së përpilimit të deklaratës noteriale të shtetasit F. Sh.), kërkojnë të provojnë ngjarje të ndodhura përpara dhënies së vendimit të Komisionit, dhe që janë evidentuar gjatë hetimit administrativ. Paraqitja për herë të parë e këtyre akteve me parashtrimet në Kolegj, në kushtet kur nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është provuar pamundësia e paraqitjes së tyre gjatë hetimit administrativ apo në ankim, i bën ato të papranueshme në cilësinë e provës së re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Edhe në eventualitetin e tejkalimit të këtij kriteri formal, trupi gjykues, nga analizimi i përmbajtjes së këtyre akteve, e vlerëson marrjen e tyre në cilësinë e provës, të panevojshme edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, bazuar në analizën sa vijon: (i) Deklarata noteriale e shtetasit F. Sh. e vitit 2025, pa rënë në përsëritje me sa më lart lidhur me fuqinë provuese të deklaratave noteriale të paraqitura gjatë procesit, nisur edhe nga përmbajtja e saj, përmes të cilës ky shtetas ka potencuar se marrëdhënia e miqësisë mes tij dhe subjektit të rivlerësimit ishte forcuar edhe për shkak të një rrethane të re (mbështetja që subjekti i rivlerësimit i kishte dhënë të afërmit/familjarit të huadhënësit në një periudhë të vështirë që ai po kalonte), të padeklaruar më herët prej tij kur ishte thirrur nga Komisioni për të dhënë shpjegime në cilësinë e dëshmitarit, krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit. (ii) Kontrata e vitit 2019, për zgjatjen e afatit të huas së vitit 2012, deri në datën 05.09.2022, jo vetëm që nuk krijon bindjen mbi besueshmërinë e kësaj marrëdhënieje huaje, por në kushtet kur një shtyrje e tillë e afatit bëhet jo në përfundim të afatit të huas, sipas kontratës së datës 18.09.2012, që do të ishte data 05.09.2017, por bëhet më datë 24.12.2019, pra 2 (vite) pas përfundimit të këtij afati, ndërkohë që procesi i rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit kishte nisur dhe po vijonte, e vendos ndërmarrjen e këtij veprimi juridik në kontekstin e procesit të rivlerësimit.

(iii) Lidhur me aktet e paraqitura²⁶ në funksion të shkakut të ankimit të trajtuar në paragrafin 63 të këtij vendimi, me qëllim për të provuar faktin se nga marrëveshja e bashkëpunimit/investimit të vitit 2012, mes bashkëshortes dhe shtetasit Z. Z., nuk janë realizuar përfitime, qoftë për shkak të pamundësisë financiare të këtij të fundit si pasojë e detyrimeve të shumta ndaj të tretëve, ashtu dhe për shkak të arrestimit e dënimit të këtij shtetasi, trupi gjykues konstaton se këto akte (pavarësisht datës së përpilimit të deklaratës noteriale të vitit 2025 të

²⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2025, e shtetasit F. Sh., dhe kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2019, “Për një ndryshim në kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2012”, për zgjatjen e afatit të huas.

²⁶ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.2025, e shtetasit Z. Z.; -- deklaratë noteriale “njohje detyrimi monetar” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2021, e deklaruesve G. G. dhe Z. Z.; -- shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 24.09.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; -- urdhër i datës 21.06.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; -- vendim nr. {***}, datë 23.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 13.03.2023.

shtetasit Z. Z. dhe shkresës përcjellëse të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë), kërkojnë të provojnë ngjarje të ndodhura përpara dhënies së vendimit të Komisionit, në funksion të fakteve të evidentuara gjatë hetimit administrativ. Paraqitja për herë të parë e këtyre akteve me parashtrimet në Kolegj, në kushtet kur nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është provuar pamundësia e paraqitjes së tyre gjatë hetimit administrativ apo në ankim, i bën ato të papranueshme në cilësinë e provës së re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Edhe në eventualitetin e tejkalimit të këtij kriteri formal, trupi gjykues, nga analizimi i përmbajtjes së këtyre akteve, e vlerëson marrjen e tyre në cilësinë e provës, të panevojshme edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, bazuar në analizën sa vijon: (i) Deklarata noteriale e vitit 2025 e shtetasit Z. Z., përmes të cilës ai konfirmon dështimin e investimit për shkak të sekuestrimit të aksioneve të shoqërisë dhe të gjitha pronave të tij nga zyra të ndryshme përmbartimore, pa rënë në përsëritje lidhur me fuqinë provuese të deklaratave noteriale të paraqitura gjatë procesit, nisur dhe nga përmbajtja e saj, krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. (ii) Deklarata noteriale për njohje detyrimi monetar e datës 08.01.2021, e hartuar disa ditë përpara nisjes efektive (dërgimit të pyetësorit standard më datë 18.01.2021) të hetimit administrativ ndaj subjektit, përmes të cilës shtetasi Z. Z. konfirmon mosrealizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2012 mes tij dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, duke i njohur asaj si detyrim shumë e investuar prej saj dhe fitimin e pritshëm, në total në shumën 130.000 euro, nuk rezulton e paraqitur ose e bërë e njohur nga subjekti gjatë hetimit administrativ kur është pyetur specifikisht mbi përfitimet financiare të marrëveshjes,²⁷ duke krijuar bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Ai nuk ishte bindës as gjatë gjykimit në Kolegj, kur, i pyetur shprehimisht se përse kjo deklaratë noteriale nuk ishte paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision, deklaroi se nga Komisioni ishte pyetur nëse janë siguruar apo jo përfitime nga kjo marrëveshje, ndërkohë që sipas tij, kjo deklaratë nuk kishte të bënte me pjesën e fitimit, përkundrazi, në të konfirmohej se nuk janë dhënë përfitime. (iii) Vendimi nr. {***}, datë 23.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***} datë 13.03.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, së bashku me urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi të organit të prokurorisë së datës 21.06.2023, japin informacion mbi arrestimin e shtetasit Z. Z., në korrik të vitit 2021, dhe dënimin e tij, në vitin 2022, për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ndërkohë që marrëveshja e bashkëpunimit mes këtij shtetasi dhe bashkëshortes së subjektit, pretendohet se vijonte të ishte në fuqi që prej vitit 2012.

(iv) Lidhur me dy vendimet e KRRt-së Komuna Dajt,²⁸ të paraqitura sërish në funksion të shkakut të ankimit të trajtuar në paragrafin 63 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se këto

²⁷ Me pyetësorin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije mbi përfitimet financiare të realizuara nga marrëveshja e investimit, nga momenti i nënshkrimit deri aktualisht. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti ka deklaruar: “Lidhur me marrëveshjen e mësipërme të bashkëpunimit, nuk është realizuar asnjë përfitim financiar, pavarësisht kërkimeve të realizuara tek z. Z. Mospagimi, jo vetëm i përfitimit financiar sipas marrëveshjes së mësipërme por edhe i vetë shumës që i është dorëzuar z. Z. si financim, ka krijuar shumë vështirësi dhe pengesa në shlyerjen e detyrimeve monetare që ne kemi pasur si familje”[...].

²⁸ Kopje vendimi nr. {***} i KRRt-së nr. {***}, datë 27.09.2011 dhe nr. {***}, i KRRt-së nr. {***}, datë 27.09.2011, shoqëruar me formularët “Mbi treguesit për llogaritjen e 4% të vlerës së investimit sipas preventimit të objektit që do të ndërtohet”.

akte, të administruara pjesërisht²⁹ edhe në Komision, edhe nëse do të kalonin problemet e formës ligjore (pasi nuk janë akte origjinale ose të njësuara me origjinalin), përveçse nuk përmbushin kushtet e provës së re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, edhe në eventualitetin e tejkalimit të këtyre pengesave, referuar përmbajtjes së tyre, nga e cila përftohet informacion mbi dhënien e dy lejeve të ndërtimit në vitin 2011 nga KRRt-ja e Komunës Dajt, pronarëve të truallit, për ndërtimin e dy komplekseve të banimit në fshatin {***} të Komunës Dajt, sikurse pasqyruar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit të vitit 2012, nuk sjellin ndonjë të dhënë të re në drejtim të shkakut të ankimit, duke u konsideruar të panevojshme edhe në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

19. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe pretendimet në parashtrime, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, arriti në përfundimet e mëposhtme:

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

I. Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 92 m², në rrugën “{}”, Tiranë***

20. Komisioni ka arritur në konkluzionin³⁰: “[...] Në përfundim të sa më sipër, konstatimet për mungesën e burimeve të ligjshme financiare, në masat - 402.536 lekë dhe - 206.655 lekë (të vitit 2005), mbeten të pandryshuara. Megjithatë, në konkluzion, për sa i përket kësaj pasurie, Komisioni çmon se bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe duke mbajtur në konsideratë masën e kësaj pamjaftueshmërie, ajo nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe për pasojë, nuk mund të përbëjë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por do të mbahet në konsideratë për t’u vlerësuar në një kontekst gjithëpërfshirës, në raport edhe me konstatime të tjera sa i takon kriterit të pasurisë”. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim këtë konkluzion, duke e konsideruar arbitrar, të paligjshëm e të marrë pa analizuar provat e administruara³¹, mbështetur në disa pretendime që trajtohen në vijim:
21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare, nuk ka përfshirë në burimet e pagesës së kësaj prej 20.000 eurosh, të ardhurat e bashkëshortes për vitet 2000 – 2004 nga puna në Bashkinë Peqin, në një kohë që këto të ardhura janë deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë vetting dhe vërtetohen përmes vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Peqin. Mosdeklarimi i tyre në DIPP-në e vitit 2004, që ka ardhur për shkak të paqartësisë së tij në plotësimin e formularit respektiv, megjithëse nuk është konsideruar nga Komisioni si

²⁹ Vendimi nr. {***} i KRRt-së nr. {***}, datë 27.09.2011, rezulton të jetë pjesë e praktikës së përcjellë në Komision nga notere G. Sh.

³⁰ Shih paragrafët 50 dhe 51 të vendimit të Komisionit.

³¹ Vërtetim dt. 20.10.2016, i Bashkisë Peqin, për të ardhurat e bashkëshortes; -- deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 12.10.2022 e bashkëshortes; -- deklarata vetting; -- vërtetimi i ISSH-së mbi pensionin e nënës; -- skeda e pensionit të nënës bashkëngjitur vërtetimit nr. {***} prot., dt. 31.10.2022; -- deklaratimet periodike të viteve 2005, 2006, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014; -- deklaratë noteriale e të motrës M. K. nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 11.06.2021; -- dokumentet e lëshuara nga autoritetet e ShBA mbi të ardhurat e motrës M. K. nga punësimi në ShBA, të legalizuara, apostiluara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe; -- analiza financiare e kryer nga eksperti kontabël i miratuar E. M.; -- shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

pasaktësi, janë përlllogaritur në totalin e analizës financiare, duke shtuar padrejtësisht vlerën e balancës finale, në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit³², sipas të cilës pasaktësitë në deklaratat periodike që nuk shoqërohen me mungesë burimesh të ligjshme financiare, nuk mund të shërbejnë si shkak për ta kualifikuar subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Në DIPP-në e vitit 2004, nga ana e tij, nuk janë deklaruar jo vetëm kursimet e bashkëshortes por edhe të ardhurat e saj të vitit 2004 (viti i lidhjes së martesës, dhe i pari për të cilin duhet të deklaronte për bashkëshorten), të cilat për atë vit kanë qenë në shumën 154.056 lekë, ndërsa të ardhurat totale kanë qenë në shumën 683,495 lekë. Të ardhurat dhe kursimet nga punësimi i bashkëshortes në Bashkinë Peqin, kanë qenë tërësisht të ligjshme, e për këtë arsye, nuk ka pasur asnjë arsye për të mos i deklaruar, veç faktit që ka qenë i paqartë lidhur me rrethanat që duhet të paraqiteshin në deklaratë.

22. Në kuadër të shqyrtimit të këtyre pretendimeve, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

22.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sip. 92 m², ku 10 % është sipërfaqe e jashtme e përbashkët. Posedohet dhe gëzohet në bazë të kontratës për premtim shitjeje nr. vërtetimi {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2005, me shoqërinë “{***}” ShPK. Paguar shuma prej 40.500 eurosh. Burim krijimi: Shuma 20.500 euro paguar nga të ardhurat dhe kursimet familjare, ndërsa shuma 20.000 euro në bazë të kontratës së kredisë nr. {***}, datë 20.09.2007. Vlera 40.500 euro. Pjesa takuese 50%”. Në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” deklarohen, ndër të tjera: “Të ardhura nga paga e bashkëshortes si përgjegjëse administrate pranë Bashkisë Peqin, për periudhën 01.12.2000 – 23.08.2004, në vlerën 683.495 lekë”. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kësaj deklarate, ndër të tjera:

(i) Kontratë premtim shitje e datës 13.07.2005, të lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator F. Sh. në cilësinë e shitësit (pronar i truallit) dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit, me objekt shitblerjen e pasurisë “Apartament 2+1, me sipërfaqe ndërtimore 92 m²,” me çmim 40.480 euro, i cili do të likuidohet sipas kësteve: 1. Kësti i parë: ditën e lidhjes së kontratës 20.480 euro; 2. Kësti i dytë: 16.000 euro do të likuidohet me marrjen në dorëzim të apartamentit. 3. Vlera e mbetur prej 4.000 eurosh do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes dhe regjistrimin e apartamentit në ZRPP Tiranë në emër të blerësit. Pagesat e kësteve do të bëhen në numrin e llogarisë së Shoqërisë “{***}” ShPK, Tiranë.³³

(ii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2005, e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, F. Sh., në të cilën ai deklaroi se ka marrë në dorëzim nga subjekti, 20.000 euro si pagesë e kështit të parë për apartamentin që ai do të blejë, i cili po ndërtohet në rrugën “{***}”.

³² Vendimet e Kolegjit nr. 6, datë 17.03.2022; nr. 33, datë 03.11.2021; nr. 37, datë 24.11.202; nr. 24, datë 28.07.2021 dhe nr. 28, datë 23.10.2020.

³³ Nga dokumentacioni i përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.09.2020, të ASHK-së Tirana Veri, rezultoi se kontrata përfundimtare e shitblerjes për këtë pasuri është lidhur mes palëve më datë 29.12.2017, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe është regjistruar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij më datë 06.01.2018.

(iii) Kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2007, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka marrë pranë Bankës Amerikane ShA,³⁴ kredi në vlerën 20.000 euro, me afat 15 vjet, me qëllim përdorimin për shlyerjen e detyrimeve të marra për blerjen e apartamentit.

(iv) Vërtetim i Bashkisë Peqin, datë 21.10.2016, sipas të cilit vërtetohet se znj. G. G. ka qenë punonjëse pranë kësaj bashkie me detyrë Përgjegjëse Administrate, për periudhën 01.12.2000 deri më 23.08.2004, dhe të ardhurat e realizuara prej saj për çdo vit në këtë periudhë: *viti 2000 - 10.772 lekë (paga neto); 2001 - 127.048 lekë; 2002 - 152.276 lekë; 2003 - 239.343 lekë; 2004 - 154.056 lekë.*

22.2 Në deklarinimin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë të vitit 2004, në rubrikën e pasurive deklarohet: *“1. Depozitë NBG greke nga të ardhurat në vite. Vlera 400.000 lekë. 2. Depozitë NBG greke, dhuratë nga vëllai emigrant në Greqi. Vlera 4.700 euro. 3. Kesh. Dhuratë nga vëllai emigrant në Greqi. Vlera 400.000 lekë”*. Në rubrikën “Të ardhurat” janë deklaruar paga e subjektit në shumën 816.000 lekë, dhe pensioni i nënës në shumën 96.000 lekë.

22.3 Në deklaratën e interesave private periodike (në vijim “DIPP”) të vitit 2005, nuk deklarohen pasuri apo shtesa/pakësime. Në rubrikën “Të ardhurat ...” janë deklaruar: paga e subjektit në shumën 813.249 lekë, dhe paga e bashkëshortes në shumën 100.000 lekë. Në rubrikën “Të dhëna që nuk publikohen” deklarohet: *“Kontratë premtim shitje banese me shtetasin F. Sh.”*, por pa specifikuar të dhëna të tjera, si sipërfaqja, vendndodhja, çmimi i pasurisë objekt i kësaj kontrate, vlerat e paguara dhe burimi i tyre apo detyrimi i mbetur.

22.4 Në DIPP-në e vitit 2006, deklarohet: *“Shtuar 270.000 lekë”*, pa specifikuar nëse bëhet fjalë për shtesë në likuiditetet *cash* apo në llogari bankare. Në rubrikën mbi të ardhurat, janë deklaruar të ardhura të subjektit si prokuror në shumën 813.249 lekë, dhe të ardhurat e bashkëshortes si juriste në shoqërinë {***} dhe në {***}, përkatësisht në shumën 100.000 lekë dhe 450.000 lekë.

22.5 Në DIPP-në e vitit 2007, deklarohet: *“Apartament, sip. 92 m², pallat i ri, pa numër, rr. {***} pranë ZVRPP. Kontratë premtim shitje, maj 2005. Vlera 40.500 euro. Pjesa takuese 50%. Kredi bankare 20.000 euro + interes vjetor 5.4%, kohëzgjatja 15 vjet, kësti mujor 183.30 euro. Shuma e shlyer 549 euro”*.

22.6 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³⁵ se ka lidhur martesë me bashkëshorten e tij në vitin 2004. I pyetur më tej mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për pagimin e kështit të parë të apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:³⁶ *“Sa i takon kësteve të parapaguara ndaj z. F. Sh., shpjegoj se këto pagesa janë kryer në vitin 2005, në shumën totale 20.480 euro. Burimi i të ardhurave për këto pagesa janë si vijon: 1. Paga*

³⁴ Nga dokumentacioni i përcjellë nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, rezulton se për marrjen e kësaj kredie është vendosur në hipotekë pasuria me nr. {***}, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, në pronësi të z. F. Sh., sipas kontratës së hipotekës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2007.

³⁵ Në përgjigje të pyetësorit standard.

³⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7.

personale për periudhën 2002 – 2005 [...]; 2. Të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, si bursë e përfiturar në vitet 2000 – 2003; [...]. 3 Kursimet familjare të krijuara deri në vitin e parë të deklarimit të pasurisë, pra vitin 2003, për krijimin e të cilave kanë shërbyer të ardhurat nga pensioni i nënës deri në atë vit, paga ime (e përshkruar më lart), pagesa nga Shkolla e Magjistraturës (e përshkruar më lart), kontributi financiar nga vëllai i punësuar në Greqi dhe motra e punësuar në ShBA. 4. Paga e bashkëshortes në vitet 2000 – 2004 si e punësuar në Bashkinë Peqin [...]. 5. Dhurimet që vëllai im M. B. më ka dhënë për të më ndihmuar me qëllim blerjen e shtëpisë [...].” Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dokumentuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për këto pagesa, subjekti i rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes për vitet 2000 – 2004, ka depozituar³⁷ krahas vërtetimit të Bashkisë Peqin cituar më lart, edhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2022, të bashkëshortes G. G., në të cilën ajo ka deklaruar se ka qenë e punësuar pranë Bashkisë Peqin në periudhën 01.12.2000 deri 23.08.2004, dhe nga punësimi ka siguruar të ardhura që arrijnë në vlerën totale prej 683.495 lekësh, vlerë të cilën e ka kursyer duke e mbajtur *cash*. Nga kjo shumë, ajo deklaroi se ka shpenzuar për nevojat personale rreth 100.000 lekë, kurse pjesën tjetër të të ardhurave e ka kursyer dhe i ka përdorur për të paguar një pjesë të vlerës, prej 20.000 eurosh, shtetasit F. Sh., në kuadër të porositjes, në vitin 2005, të apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

22.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, ka arritur në konkluzionin paraprak se kursimet e bashkëshortes të pretenduara të realizuara për periudhën 2000 – 2004, nuk mund të konsiderohen si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie, për sa kohë që nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2004. Në shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin paraprak të Komisionit, duke parashtruar të njëjtat argumente si në ankim, cituar më lart.

23. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar analizës financiare për periudhën 2003 – 2016³⁸, vëren fillimisht se Komisioni ka përfshirë për vitin 2004 (i cili rezulton me balancë pozitive) të ardhurat e këtij viti, të bashkëshortes, në shumën 154.056 lekë. Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimit, trupi gjykues vëren se, konkluzionin për të mos përfshirë kursimet e bashkëshortes nga të ardhurat e pretenduara për periudhën 2000 – 2004 nga puna e saj në Bashkinë e Peqinit, Komisioni ja atribuon mungesës së deklarimit të tyre si gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2004, duke qenë se ata janë lidhur në martesë në vitin 2004. Në këtë drejtim, në analizë të kuadrit ligjor lidhur me detyrimin e subjekteve për deklarim të pasurisë dhe interesave private, rezulton se, sipas nenit 4 dhe nenit 21 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjektet deklarues duhet të deklaronin, ndër të tjera, edhe vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, për veten, bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore. Në zbatim të përmbushjes së këtij detyrimi në rastin konkret, nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2004, trupit gjykues nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar kursime të bashkëshortes si likuiditet *cash* apo në bankë. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paqartësi në plotësimin e deklaratave periodike vjetore, si dhe argumentet e parashtruara prej tij, janë jobindëse dhe bien ndesh me gjuhën e ligjit nr. 9049/2003 dhe formularit respektiv. Këto akte përcaktojnë qartë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e likuiditetit *cash*, pa lenë

³⁷ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

³⁸ Shih tabelën e analizës financiare në faqen 41 të vendimit të Komisionit.

vend për dyshime për disponimin e tyre në mënyrë të nënkuptuar bazuar vetëm në deklarinimin e të ardhurave. Së fundmi, pretendime të kësaj natyre, sikurse ka konstatuar Kolegji në vendime të mëparshme³⁹, bien ndesh edhe me profilin profesional të subjektit si magjistrat/prokuror, që kërkon përgjegjësi, qartësi dhe njohuri të thelluara në interpretimin e ligjit, në funksion të të drejtave të individëve dhe interesit publik në ndjekjen penale. Në këto rrethana, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mos përfshirë në burimet e krijimit të pagesës së kështit të parë të apartamentit, kursimet e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, krijuar me të ardhurat nga puna e saj në Bashkinë Peqin për periudhën dhjetor 2000 – 2004, pasi pavarësisht se provohet ekzistenca e këtyre të ardhurave, për sa kohë ato nuk janë deklaruar në deklaratën e interesave private periodike për vitin 2004, si gjendje *cash*, nuk mund të prezumohet disponimi i tyre në fund të vitit 2004.

24. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni, në mënyrë arbitrare, nuk ka përfshirë në pagesën e shumës prej 20.000 eurosh, në datën 31.05.2005, kontributin e nënës në shumën 250.000 lekë, krijuar nga pensioni i vitit 2004 në vlerën 101.503 lekë, pensioni deri në datë 31.05.2005 në vlerën 97.905 lekë, dhe ndihma e motrës emigrante në ShBA dhe vëllait emigrant në Greqi, bazuar në argumentet si vijojnë: (i) pensioni i nënës është deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting sipas ligjit nr.84/2016, ndërsa ndihma ekonomike e motrës dhe vëllait nuk ka qenë rrethanë që duhet të deklarohet në deklaratën vetting nga nëna, sa kohë që nuk ka shërbyer për të krijuar pasuri në pronësi të saj; (ii) bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ai nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat dhe kursimet e nënës së tij në deklaratimet periodike dhe kjo nuk mund të passjellë mospërfshirjen e tyre në totalin e të ardhurave dhe kursimeve të familjes së tij; (iii) pensioni i nënës është e ardhur tërësisht e ligjshme dhe e provuar me aktet shkresore të ISSh-së, ndërkohë që janë provuar me dokumente të lëshuara nga autoritetet e ShBA-së dhe Greqisë të ardhurat e ligjshme të motrës dhe vëllait emigrantë; (iv) ndodhur në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar dërgesat nëpërmjet Western Union, dërgimi i shumave monetare provohet me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2021, të motrës M. K.; (v) referuar vendimit të KPA-së nr. 18, datë 26.07.2019 e cila ka theksuar standardin se nuk mund të deklarohen likuiditete që kanë qenë në administrim të prindërve dhe familjes së subjektit, Komisioni duhet të kishte pranuar kursimet e nënës së tij krijuar në mënyrë të pavarur dhe të shkëputur nga të ardhurat e tij; (vi) analiza financiare e kryer nga eksperti kontabël E. M. provon se “Diferenca rezultuar në 2005 nga KPK ka pasur mundësi financiare për t’u përballuar me: kursimet kumulative të nënës nga shumat e dhëna nga motra dhe vëllai; të ardhurat nga i vëllai në Greqi; shumat e mbartura dhe të akumuluar nga vitet e mëparshme”.*
25. Në shqyrtim të pretendimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kontributin e nënës në shumën 250.000 lekë, krijuar nga pensioni i vitit 2004, pensioni deri në datë 31.05.2005 dhe ndihmat e motrës dhe vëllait emigrantë, përkatësisht në ShBA dhe në Greqi, nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe nga kontrolli i arsytimit të Komisionit në këtë drejtim, trupi gjykues përveç sa parashtruar në paragrafët 22.1 - 22.6, më lart konstaton dhe vlerëson sa vijon:

³⁹ Shih, ndër të tjera, edhe vendimin e Kolegjit në çështjen nr. 27/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka, paragrafin 19.4.v apo paragrafin 27.12.16, në vendimin në çështjen nr. 11/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islami.

25.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, ndër burimet e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, konkretisht të kështit prej 20.500 eurosh, ka deklaruar të ardhurat dhe kursimet familjare. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti ka paraqitur mes të tjerash: (i) certifikatë familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr. {***}, Tiranë, më datë 24.01.2017, sipas të cilës familja e subjektit përbëhet nga 6 anëtarë, ndër të cilët edhe nëna Sh. Sh.; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 24.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas të cilit të ardhurat e pensionit të znj. Sh. Sh., nga data 01.01.2002 – 31.10.2016, janë në total 2.189.777 lekë.

25.2 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetjes mbi personat me të cilët ka bashkëjetuar për çdo vit të periudhës së deklaramit dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës, subjekti ka deklaruar⁴⁰ se që prej vitit 2003, ka jetuar me nënën dhe të motrën, ku kjo e fundit është larguar në vitin 2006, pasi është martuar. Ai ka shpjeguar më tej se me martesën e tij në vitin 2004, atyre iu është bashkuar edhe bashkëshortja G. G., dhe se shpenzimet janë mbuluar me të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: *“Në vitet e mësipërme dhe në vite të mëparshme nga periudha e mësipërme, unë personalisht, nëna ime dhe familja ime, jemi ndihmuar financiarisht nga vëllai M. B., i cili ka qenë emigrant në Greqi dhe motra, M. K., e cila ka qenë dhe është emigrante në ShBA. Kjo mbështetje ka shërbyer për nevoja të ndryshme që paraqiteshin për familjen (shpenzime apo kursime të miat si deklarues dhe të mamasë time)”*.

25.3 Në vijim të hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dokumentuar burimin e ligjshëm të pagesave të apartamentit objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar⁴¹ *[...] veç të ardhurave të vitit 2002 dhe atyre para vitit 2002, të cilat kanë shërbyer për të krijuar kursime të përbashkëta, të cilat janë depozituar në NBG, në vitet 2002 dhe 2004, në depozita të ndryshme, pjesa tjetër e pensionit të nënës dhe e kontributit që asaj i është ofruar nga vëllai M. B. dhe motra M. K., nuk është prekur/përdorur nga ne fëmijët, por është ruajtur nga vetë nëna. Me këto të ardhura ajo ka krijuar një vlerë monetare të kursyer, e cila nuk është deklaruar nga ana ime në DIPP-të vjetore për shkak se nëna nuk përfshihej në rrethin e personave për të cilët duhet të deklarohet, vlerë që, në rastet kur paraqitet e nevojshme ma vendoste në dispozicion dhe është përdorur nga ana ime, me qëllim për përmbushur nevojat e ndryshme familjare. [...] Në këtë mënyrë, nëna jonë ka mundur të krijojë kursime, duke ruajtur pensionin e saj dhe ndihmën e ofruar nga motra M. dhe vëllai M. [...] Një pjesë nga shuma 20.000 euro, konkretisht vlera rreth 560.000 lekë është paguar duke përdorur: 1. Të ardhurat personale nga paga e vitit 2005; 2. Kursimet e nënës nga pensioni dhe ndihma e motrës dhe e vëllait; 3. Kursimet e bashkëshortes G., të krijuara nga punësimi në Bashkinë Peqin për vitet 2000 – 2004. Me sa kujtoj, për plotësimin e shumës 560.000 lekë, nga kursimet e mia cash të deriatëhershme, kam kontribuar me shumën rreth 150.000 lekë, nga kursimet e nënës janë përdorur 250.000 lekë dhe diferenca është paguar nga kursimet e ruajtura prej bashkëshortes nga paga e saj. Kujtoj që nëna më ka dhënë për të përdorur gjithë pensionin që kishte marrë në vitin 2004, pensionin e vitit 2005 të marrë deri në muajin maj, dhe pjesën tjetër e ka dhënë nga kursimet e krijuara nga ndihma që i kishte dhënë motra ime M. [...]. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur këtyre shpjegimeve dokumentet si vijojnë:*

⁴⁰ Në përgjigje të pyetësorit standard.

⁴¹ Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 7.

(i) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2022, të vëllait, M. B., në të cilën ai deklaroi: “[...] Nga punësimi si emigrant në Greqi, kam siguruar të ardhura monetare të konsiderueshme, një pjesë të të cilave, të deklaruara pranë organeve kompetente tatimore, i kam vënë në dispozicion të vëllait tim në vitet 2003 dhe 2004. [...] Veç ndihmës së mësipërme unë kam ndihmuar financiarisht edhe nënën time Sh. Sh., me qëllim që ajo të kishte të ardhura të mjaftueshme për çdo nevojë që mund t’i paraqitej”, shoqëruar me dokumentacion mbi të ardhurat e tij nga punësimi në Greqi për periudhën 1998 – 2004, legalizuar me vulë apostile dhe vërtetime përkthimi.

(ii) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2021, e të motrës, M. K., në të cilën ajo deklaroi se, nga viti 2000 e në vijim, i ka dhuruar nënës Sh. Sh., e cila nuk jeton më, shuma të ndryshme monetare nga 1500 – 2500 USD në vit, ku vlera totale arrin rreth 18.000 - 20.000 USD, shoqëruar me dokumentacion mbi të ardhurat e saj nga punësimi në ShBA për periudhën 1998-2010, legalizuar me vulë apostile dhe me vërtetim përkthimi.

(iii) Shkresë nr. {***} prot., datë 13.10.2022, e Postës Shqiptare ShA, përmes të cilës përcillen të dhëna mbi shërbimet postare të subjektit dhe familjarëve të tij, për periudhën 2013 – 2022, duke informuar se për periudhën 2002 – 2013, nuk disponohen të dhëna për shkak të kalimit të afatit të ruajtjes së dokumenteve.

(iv) Shkresë nr. {***} prot., datë 07.10.2022, e Unionit Financiar Tiranë, me anë të së cilës informohet se të dhënat personale të klientëve mbahen deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare për klientin, ndërkohë janë listuar 4 transferta në mbërritje për subjektin e rivlerësimit, nga e motra, M. K., që i përkasin viteve 2018, 2019, 2021 dhe 2022.

25.4 Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit konkluzionin paraparak, për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme kursimet e pretenduara të nënës, me burim të ardhurat nga pensioni i saj i vitit 2004 dhe 5 (pesë) muaj të vitit 2005, si dhe nga shumat e dërguara nga e motra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, argumentuar me faktin se të ardhurat e nënës nga pensioni janë deklaruar nga subjekti në të ardhurat familjare, e për rrjedhojë edhe në kursimet familjare, dhe se nga ana e tij nuk ishte deklaruar ndonjë shumë konkrete e këtyre kursimeve. Në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka kundërshtuar mospërfshirjen në analizën financiare të kursimeve të nënës nga pensioni dhe ndihmat e dhëna asaj nga motra dhe vëllai emigrantë, me të njëjtat argumente si ato të parashtruara në ankim, shoqëruar me një relacion financiar të përgatitur nga eksperti E. M., në të cilin rezultoi që të jenë përfshirë në analizën financiare të periudhës janar – maj 2005 të ardhura të nënës nga pensioni në vlerën 97.905 lekë, ndërsa kursimet kumulative të nënës, 2001 – 2004, në vlerën 776.422 lekë.

26. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, në raport me konkluzionin e Komisionit, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit, vëren fillimisht se Komisioni ka vlerësuar të mos përfshijë në analizën financiare, kursime veçmas të nënës nga të ardhurat e pensionit, sa kohë këto të ardhura janë përfshirë në ekonominë e përbashkët familjare dhe nuk janë deklaruar si gjendje *cash*, sikurse janë deklaruar të ardhurat nga pensioni i saj ndër vite.⁴² Në këtë drejtim, nga kontrolli i kryer në Kolegj, rezultoi se të ardhurat nga pensioni i nënës për 5 (pesë) muajt e vitit 2005, janë përfshirë nga Komisioni në të ardhurat e përdorura për pagesën e këstit të parë

⁴² Shih paragrafin 50 të vendimit të Komisionit.

të apartamentit. Nga verifikimi i përbërjes familjare sipas deklaratave të interesave private periodike ndër vite dhe certifikatave familjare të administruara nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nga momenti i deklarimit fillestar të pasurisë në vitin 2004, si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me nënën e tij. Krahas këtij informacioni, referuar deklaratimeve të kryera gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, teksa ka deklaruar se ka jetuar gjatë gjithë periudhës (duke nisur nga viti 2003) në të njëjtën banesë me nënën dhe shpenzimet janë mbuluar me të ardhurat familjare, pra duke pasur një ekonomi të përbashkët me të, njëkohësisht ka pretenduar që nëna ka pasur edhe kursime veçmas krijuar me të ardhurat nga pensioni për vitin 2004 dhe 5 muajt e parë të vitit 2005, si dhe ndihmat e dhëna nga motra e vëllai i subjektit, emigrantë, të cilat janë përdorur prej tij në momente të caktuara kur ka pasur nevojë. Ndërkaq, në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimi i krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi deklarohet “të ardhura e kursime familjare”, pa e identifikuar qartësisht përbërjen apo prejardhjen e këtij burimi, ndërsa në DIPP-në e vitit 2005 dhe 2007, nuk rezulton i deklaruar burimi i krijimit të pasurisë sipas kërkesave të ligjit nr. 9049/2003. Këto rrethana, në vlerësimin e trupit gjykues, e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kursime individuale të nënës, duke u konsideruar si përpjekje për të zgjeruar ose justifikuar burimet e pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, sa i takon kursimeve të pretenduara të nënës, të administruara në mënyrë të pavarur prej saj me të ardhura nga pensioni i vitit 2004, në vlerësimin e trupit gjykues, pavarësisht mungesës së detyrimit ligjor të subjektit të rivlerësimit për të deklaruar në deklaratat e interesave private periodike likuiditetet *cash* të disponuara në mënyrë të pavarur nga nëna, dhe ekzistencës së të ardhurave të ligjshme të saj nga pensioni dhe ndihmave të vëllait dhe të motrës emigrantë, në kushtet kur të ardhurat nga pensioni janë përfshirë nga Komisioni në ekonominë e përbashkët familjare për këtë vit, si dhe në kushtet e mosdeklarimit si burim të vlerës ekzakte të pretenduar në deklaratën e pasurisë *vetting*, ato nuk mund të përfshihen në burimet financiare të pagesës së kështit të parë të apartamentit objekt shqyrtimi.

27. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në fund të vitit 2004, përveç kursimeve të nënës, ka pasur disponibël një vlerë cash prej 450.000 lekësh, me burim të ardhurat e vitit 2004, të krijuar nga të ardhurat nga paga, për shkak të shpenzimeve më të ulëta në raport me të ardhurat, e cila pavarësisht mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2004, për shkak të paqartësive që kishte në plotësimin e deklaratave, ka ekzistuar dhe është tërësisht e justifikuar me të ardhura të ligjshme, çka pasqyrohet edhe në analizën financiare të Komisionit, e cila për vitin 2004, ka rezultuar me bilanc pozitiv në vlerën 470.263 lekë. Vlera prej 450.000 lekësh, e kursyer cash, i është bashkuar shumës tjetër të vlerave monetare të disponuara në vitin 2004, kurse vlerat e tjera të kursimeve të pasqyruara për vitet 2003 e 2004, janë deklaruar për arsye se, për krijimin e tyre, nuk kishin shërbyer vetëm të ardhurat e tij. Gjithashtu, subjekti pretendon se Komisioni, nuk ka përlllogaritur shumën prej 150.000 lekësh të pakësuar në datë 31.05.2005 nga gjendja cash që posedohej prej tij. Ndërsa pjesa e mbetur nga gjendja cash, në shumën 250.000 lekë, është mbajtur e paprekur dhe të cilës i është shtuar edhe gjendja e krijuar nga të ardhurat e vitit 2005, të cilat edhe sipas Komisionit janë të mjaftueshme për të rikrijuar gjendjen cash në shumën totale 400.000 lekë.*

27.1 Në vlerësim të këtyre pretendimeve, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupit gjykues i rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizën e burimeve për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit, gjendje *cash* në fund të vitit 2004, në vlerën 400.000 lekë, dhe viti 2004 mbyllet me një balancë pozitive prej 470.263 lekësh. Nga verifikimi i deklaramit të pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë të vitit 2004, trupit gjykues nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar gjendje *cash* në vlerën 450.000 lekë me burim të ardhurat e vitit 2004, përveç gjendjes *cash* në vlerën 400.000 lekë të dhuruar nga vëllai, e cila është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare. Në kushtet kur prova e vetme e vërtetësisë së deklaramit të subjektit mbetet ajo çka është deklaruar në deklaratat periodike, trupi gjykues e gjen të pambështetur dhe deklarativ pretendimin e tij lidhur me disponimin e shumës prej 450.000 lekësh. Sa i takon pretendimit për mosllogaritjen e shumës prej 150.000 lekësh, të pakësuar në datën 31.05.2005 nga gjendja *cash* që disponohej prej tij, nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2005, trupit gjykues sërish nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* për këtë vit. Në kushtet kur shuma prej 150.000 lekësh e pretenduar nga subjekti, përfshihet në shumën prej 400.000 lekësh deklaruar si kursime *cash* në fund të vitit 2004, dhe e marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare, trupi gjykues e gjen jorelevant e të pabazuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i analizës financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të rikrijuar kursimet *cash* prej 400.000 lekësh, deri në fund të vitit 2005, trupi gjykues konfirmon konkluzionin e Komisionit për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në shumën -206.655 lekësh, për sa kohë ai nuk ka deklaruar ndryshime të këtyre kursimeve nga viti i mëparshëm.

28. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për *pasurinë* “*Apartament banimi me sipërfaqe 92 m²*”, në rrugën “{***}”, Tiranë, bazuar në qëndrimet e mësipërme, nga kontrolli i analizës financiare, konfirmohet mungesa e burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kështit të parë të apartamentit në shumën – 402.536 lekë, si dhe për rikrijimin e kursimeve *cash* në vitin 2005 në shumën – 206.655 lekë. Balanca negative në analizën financiare për vitin 2005, që do të vinte si pasojë e kësaj shtate, rezulton në shumën – 609.191 lekë. Kjo mungesë burimesh financiare të ligjshme, ashtu sikurse edhe në Komision, u konsiderua nga trupi gjykues pa peshë për t’u kualifikuar si e vetme sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por u mbajt në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

II. Në lidhje me pasurinë “*Apartament banimi me sipërfaqe 61 m²*”, në rrugën “{*}”, Tiranë, në vlerën 4.600.000 lekë**

29. Komisioni ka arritur në konkluzionin⁴³ se: “*Në mungesë të ndonjë prove mbi burime të ardhurash, që të kënaqin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni, pasi ka përlllogaritur të ardhurat e ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie, në raport me shumën e shpenzuara dhe shpenzimet jetike, ka rezultuar një pamundësi financiare në vlerën 1.852.606 lekë, siç ishte njoftuar më herët në rezultatet e hetimit, përkatësisht - 1.510.053 lekë në vitin 2009 dhe -342.552 lekë në vitin 2010. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nuk ka paraqitur plotësisht realitetin dhe për rrjedhojë ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, gjerat “b” dhe “ç” të*

⁴³ Shih paragrafin 103 të vendimit të Komisionit.

ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione kualifikohen në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, përbëjnë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”.

30. Nga kontrolli i përmbajtjes së vendimit, trupi gjykues vëren se konkluzioni i mësipërm i Komisionit lidhet me problematikat e evidentuara në një prej burimeve të deklaruara për pagesën e një pjese të çmimit të kësaj pasurie, që është huaja e marrë nga znj. H. H., dhe konkretisht me mungesën e burimeve të ligjshme të saj, duke arsyetuar se⁴⁴: *“Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë mjetet financiare të pretenduara nga huaja nga z. M., si dhe as ato nga vjehrra e subjektit. Ky konkluzion bazohet nga njëra anë tek paprovueshmëria e ekzistencës së marrëdhënies, apo momentit dhe mënyrës së marrjes së kësaj shume nga vjehrra e subjektit. Nga ana tjetër, nuk krijohet bindja se kjo hua e përfituar nga vjehrra e subjektit (edhe nëse është marrë vërtet kur pretendohet – rrethanë kjo e paprovuar dhe e paqartë), të ketë pasur realisht subjektin si destinacion dhe përfitues fundor, pra të jetë përdorur prej tij si burim për këtë banesë. Gjithashtu, sikurse është arsyetuar edhe më sipër, vërehet se burimet financiare të vetë familjes së huadhënëses (vjehrrës së subjektit) nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të justifikuar burimin e ligjshëm të huas së pretenduar. Kjo pasi burimet nga puna apo aktiviteti i tyre nuk kanë rezultuar të provuara, sikurse nuk konsiderohet bindës përdorimi për huadhënie i të ardhurave të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme në Peqin. Ky konkluzion rrjedh pikërisht nga pamundësia e burimeve të tjera alternative nga vjehrrit e subjektit, për përballimin financiar të blerjes së banesës në Durrës dhe, për rrjedhojë, Komisioni çmon se ky investim është mbuluar pikërisht me shumën e realizuara nga shitja e ndërtesës në Peqin. Kësisoj, ky burim financiar (nga shitja) nuk është destinuar në dhënien hua të kësaj shume për një investim të subjektit në një banesë të dytë, por në blerjen prej tyre të një banese më vete. Në këtë rast, Komisioni ka shtrirë analizën logjiko-faktike dhe ka konsideruar edhe parametrat dhe kontekstin financiar më të gjerë të huadhënësve, por edhe në aspektin e modus operandi të subjektit, i cili, në mënyrë të përsëritur, ka investuar në të gjitha pasuritë e tij me një kontribut financiar minimal të vetin, duke përdorur në vijimësi mjete monetare me prejardhje nga persona të tretë. Trupi gjykues vëren gjithashtu se, Komisioni, megjithëse ka vlerësuar të mos konsiderojë me të ardhura të ligjshme huan në shumën 2.000.000 lekë të znj. H. H., pamjaftueshmëria financiare e rezultuar si pasojë e kësaj shtate, nuk i atribuohet balancës negative në vlerën e plotë të huas, pra në shumën 2.000.000 lekë, por balancës negative të vitit 2009 në vlerën 1.510.053 lekë, duke sjellë kësijoj një deformim të burimit të krijimit të kësaj pasurie.*
31. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin dhe argumentet e mësipërm të Komisionit, duke e konsideruar të njëanshëm, të paligjshëm dhe të marrë pa analizuar, qoftë edhe formalisht, provat e administruara.⁴⁵ Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti ka parashtruar disa pretendime që trajtohen në vijim:

⁴⁴ Shih paragrafët 101 dhe 102 të vendimit të Komisionit.

⁴⁵ Kontratë noteriale huaje e datës 21.02.2009, e lidhur mes subjektit dhe vjehrrës H. H.; -- DIPP-të për vitet 2009 - 2015; -- deklaratat noteriale të vjehrrës H. H., të datave 24.04.2018 dhe 22.12.2018, për likuidimin e huas shtetasit A. M.; -- transfertat bankare të datave 07.12.2018 dhe 12.12.2018, nga llogaria e subjektit në llogarinë e H. H.; -- deklarata vetting; -- kontratat e shitjes të datës 26.12.2007, për pasuritë e ndodhura në qytetin e Peqinit; -- certifikatë për vërtetimin pronësie dhe kartelë pronësie e apartamentit të ndodhur në Peqin; -- deklarata e datës 01.10.2008, për marrjen hua nga vjehrra prej shtetasit A. M.; -- dy procesverbale të mbajtura në ILDKPKI të datës 19.07.2016, për dhënien e shpjegimeve dhe depozitimin e deklarates për dhënie huaje të datës 01.10.2008;-

32. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *deklarimi konsiderohet i rremë nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, ndërkohë që pasuria apartament në rrugën “{***}” është deklaruar në mënyrë tërësisht të saktë. Vetëm nëse ai do të kishte deklaruar të dhëna të rreme lidhur me sipërfaqen, çmimin, kohën e blerjes apo kontratën e blerjes, këto do të përbënin të dhëna të rreme që sipas nenit D pika 5 do të përfaqësonin deklaram të rremë.*
33. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të saktësisë së deklaramit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

33.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me adresë rruga “{***}”, nr. {***}, me sip. 61 m², pallati “{***}”, kontrata e shitjes nr. {***}, dt. 15.12.2010, lidhur mbi bazë të kontratës së porosisë nr. {***}, dt. 12.05.2009. Për pagimin e shumës, si burim ka shërbyer huaja në vlerën 2.000.000 lekë sipas kontratës {***} dt.21.02.2009; huaja në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë sipas kontratës {***} dt.02.03.2009. Pjesa prej 600.000 lekësh paguar nga kursimet familjare. Vlera 4.600.000 lekë. Pjesa takuese 50%”. Në rubrikën “Detyrime financiare ...” të kësaj deklarate deklarohet: “Hua në vlerën 2.000.000 lekë sipas kontratës {***}, datë 21.02.2009. Shuma e detyrimit të mbetur, 2.000.000 lekë”. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kësaj deklarate:*

- Kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.05.2009 e lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, Tiranë në cilësinë e investitorit dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e porositësit, me objekt “*Apartament nr. {***}, kati i {***}, i cili ndodhet në objektin 2, me sipërfaqe ndërtimi 67.7 m², i përbërë nga 61 m² sipërfaqe apartamenti plus 6.7 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallës*”, me çmim 4.600.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr.{***} rep., nr. {***} kol., datë 15.12.2010 e lidhur me shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e shitësit, dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit, me objekt kalimin e pronësisë së apartamentit me sipërfaqe 61 m², sipas së cilës çmimi i shitjes, prej 4.600.000 lekësh, është likuiduar prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, e datës 11.12.2013, sipas së cilës pasuria nr. {***}, ZK {***}, në Tiranë, rruga “{***}”, hyrja {***}, ap. {***}, me sipërfaqe 61 m²⁴⁶; figuron e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.
- Kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2009 e lidhur mes znj. H. H. (Ç.) në cilësinë e huadhënëses dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e huamarrësit. Në këtë kontratë deklarohet: “*Unë pala huadhënëse, me anë të kësaj kontrate, shprehje vullnetin tim të lirë dhe të plotë, i jap sot hua në shumën e 2.000.000 lekë të reja huamarrësit Armand Gurakuqi, që është dhe dhëndri im, pa interes, me një afat huaje deri në 5 vjet, afat i cili, sipas marrëveshjes sonë të përbashkët do të fillojë nga data e sotme, 21.02.2009 deri më 21.02.2014, që është data e kthimit të shumës totale. Kthimi total i kapitalit do të bëhet me deklaratë*

- deklaratë noteriale e datës 17.07.2020, për likuidimin e huas ndaj shtetasit A. M.; -- fotografitë në vite të ndryshme për ushtrimin e veprimtarisë së rrobaqepësisë nga vjehrra, H. H.

⁴⁶ Nga aktet në fashikull, ky apartament rezulton të jetë shitur nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2021, në çmimin 60.000 euro.

noteriale”. Nga ana e tij, huamarrësi deklaron se është dakord me sa më sipër u shpreh huadhënësi, se merr sot prej tij, jashtë kësaj zyre noteriale, hua shumën e 2.000.000 lek të reja, për një periudhë prej 5 vitesh nga data e sotme, pa interes, sipas të gjitha kushteve të përcaktuara më lart, si dhe duke respektuar të gjitha detyrimet që parashikon K. C. për huan. Gjithashtu, deklaron se është në gjendje të kthejë të gjithë shumën e huas, si një detyrim thelbësor i tij në këtë kontratë.

33.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave periodike private, të dorëzuara ndër vite pranë ILDKPKI-së, konstatohet se: (i) në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament 67.7 m², rr. ‘{***}’, Tiranë (shtuar). Kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 12.05.2009. Vlera 4.600.000 lekë. Pjesa takuese 100 %. – 4.000.000 lekë, paguar si vlerë për apartamentin në rr. ‘{***}’, pakësuar; -- 4.000.000 lekë, shtuar me dy kontrata huaje: 1) nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 21.02.2009; 2) nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 02.03.2009”. Në rubrikën “Detyrimet financiare” të kësaj deklarate, ndër të tjera, deklarohet: “Hua në vlerën 2.000.000 lekë ndaj shtetases H. H. (Ç.), kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2009 (kopje bashkëlidhur). Shuma e shlyer 0 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer: 2.000.000 lekë”. (ii) Në DIPP-të e viteve 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, subjekti ka deklaruar “Hua në vlerën 2.000.000 lekë ndaj shtetases H. H. (Ç.), sipas kontratës {***}, dt. 21.02.2009. Gjendja e detyrimit të mbetur, 2.000.000 lekë”.

33.3 Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁴⁷ se shuma e dhënë hua nga vjehrra H. H., ka si burim: (i) të ardhurat nga veprimtaria e saj si rrobaqepëse dhe tregtare ambulante në qytetin e Peqinit; (ii) të ardhurat nga shitja e një dyqani dhe apartamenti në Peqin; (iii) kontratë huaje e lidhur mes znj. H. H. dhe shtetasit A. M., person i afërm të saj. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur këtyre shpjegimeve dokumentet e mëposhtme:

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2018, e znj. H. H., e cila deklaron të likuiduar paraprakisht nga subjekti i rivlerësimit, shumën prej 800.000 lekësh në Tirana Bank ShA, në datën 24.04.2018, pjesë e huas në vlerën 2.000.000 lekë, shoqëruar me mandat bankar nga Tirana Bank të datës 24.04.2018.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, e znj. H. H., e cila deklaron të likuiduar shumën prej 1.200.000 lekësh si vijon: -- shuma prej 1.000.000 lekësh është likuiduar nëpërmjet transfertës bankare datë 07.12.2018 të Intesa Sanpaolo Bank ShA, në llogarinë e saj pranë Tirana Bank Sha; -- shuma prej 200.000 lekësh është likuiduar nëpërmjet transfertës bankare të datës 12.12.2018, nga Credins Bank ShA në llogarinë e saj pranë Tirana Bank ShA. Me këtë akt, znj. H. H. konsideron të likuiduar të gjithë shumën e huas prej 2.000.000 lekësh. Kjo deklaratë noteriale shoqërohet me akte të veprimeve bankare të datave 07.12.2018 dhe 12.12.2018, përkatësisht në Intesa Sanpaolo Bank ShA dhe Credins Bank ShA.

33.4 Në vijim të hetimit administrativ, në mbështetje të deklarimeve të tij mbi burimin e të ardhurave të znj. H. H. për dhënien e huas në vlerën 2.000.000 lekë në vitin 2009, subjekti ka paraqitur⁴⁸ procesverbal mbi shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 19.07.2016, ku në përgjigje të kërkesës së këtij institucioni për të dhënë shpjegime mbi mundësinë financiare të

⁴⁷ Në përgjigje të pyetësorit standard dhe atij vijues me nr. 2.

⁴⁸ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 7.

znj. H. H. për të dhënë hua, subjekti ka deklaruar si burime të saj: (i) të ardhura nga aktiviteti privat i rrobaqepësisë dhe si tregtare ambulante; (ii) të ardhura nga shitja e një apartamenti dhe dyqani në qytetin e Peqinit; (iii) një shumë parash të cilat i kishte marrë hua për hapje biznesi nga një person i afërm me të. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu procesverbalin mbi administrimin e dokumentacionit justifikues ligjor të datës 19.07.2016, të mbajtur pranë ILDKPKI-së, në të cilin evidentohet dorëzimi pranë këtij institucioni edhe i deklaratë për dhënie huaje, datë 01.10.2018, mes shtetasve A. M., në cilësinë e huadhënësit dhe znj. H. H., në cilësinë e huamarrëses, të shumës 2.000.000 lekë.

34. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, në drejtim të saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, huan në vlerën 2.000.000 lekë, sipas kontratës nr. {***}, datë 21.02.2009, në dy rubrika të saj, fillimisht në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, si një ndër burimet e përdorura për pagimin e një pjese të çmimit të pasurisë objekt shqyrtimi, por pa specifikuar burimet e të ardhurave të huadhënësit, dhe në rubrikën “Detyrimet financiare” si detyrim i mbetur pa shlyer. Për të dokumentuar këtë marrëdhënie, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur kësaj deklarate edhe kontratën e huas me akt noterial, nga e cila identifikohet huadhënësi që është znj. H. H.. Kjo hua është deklaruar nga subjekti edhe në DIPP-në e vitit 2009, në të njëjtën mënyrë në dy rubrikat respektive, duke evidentuar në këtë rast edhe huadhënësen, ndërkohë që në deklaratat vijuese është deklaruar si detyrim ekzistues ndaj saj. Kjo hua i është kthyer znj. H. nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2018 në rrugë bankare. Në vlerësim të këtyre rrethanave, mungesa e specifikimit të burimit të të ardhurave të vjehrrës, që kanë shërbyer për dhënien e huas në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe mosparaqitja e dokumenteve justifikuese për ligjshmërinë e tyre, sipas nenit 32, pika 1⁴⁹ e ligjit nr. 84/2016, në optikën e trupit gjykues, e bëjnë deklaramin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* jo të plotë në drejtim të justifikimit të ligjshmërisë së burimeve të vlerës së dhënë hua, sipas nenit 32, pika 4⁵⁰ e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, me qëllim kontrollin e konkluzionit të Komisionit lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, pra nëse ai ndodhet në kushtet e deklaramit të rremë, trupi gjykues verifikoi ekzistencën e burimeve të ligjshme të huadhënëses H. H. për të dhënë hua, mbi bazën e pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim.

Në lidhje me burimin “Hua nga shtetasi A. M.”

35. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, lidhur me huan e marrë nga znj. H. H., trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme këtë hua, i atribuohet ndër të tjera problematikave të konstatuara lidhur me huan e marrë prej saj, shtetasit A. M., konkretisht: (i) mungesës së provueshmërisë së kësaj marrëdhënieje, momentit dhe mënyrës së kalimit të shumës së dhënë hua nga z. A. M. tek znj. H. H.; (ii) mungesën e besueshmërisë që kjo hua të ketë pasur si destinacion të përdorimit të saj subjektin e

⁴⁹ Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

⁵⁰ Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

rivlerësimit, pavarësisht se rezultoi e provuar mundësia financiare e huadhënësit A. M. për të dhënë hua me burime të ligjshme.⁵¹

36. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *qëndrimi i Komisionit për të mos pranuar dhe mos konsideruar si provë deklaratën për dhënie huaje të datës 01.10.2008, është kundërligjshëm, i pabazuar në tërësinë e provave dhe jurisprudencën e konsoliduar të KPA-së mbi pranueshmërinë e provave, për arsytet si vijojnë: -- ndryshe nga sa shprehet Komisioni në vendim, deklarata për dhënie huaje e datës 01.10.2008 nga shtetasi A. M. tek vjehrra e tij, nuk është deklaruar për herë të parë në përgjigjet e pyetësorit nr.1, por është deklaruar e dorëzuar në datën 19.07.2016 pranë ILDKPKI-së; -- bazuar në vendimin nr. 37, datë 24.11.2021, të KPA-së, procesverbali i deklarimit të datës 19.07.2016 dhe deklarata për dhënie huaje e datës 01.10.2008, e marrë sipas këtij procesverbali, përbëjnë dokumente zyrtare dhe duhet të pranohen në cilësinë e provës nga Komisioni; -- sipas neneve 1050-1055 të Kodit Civil, nuk është e detyrueshme formalizimi i huas para një noteri dhe paraqitja e motivit apo qëllimit të saj. Përdorimi i shumës së dhënë hua për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin është dhënë, nuk cenon dhe nuk ka asnjë ndikim mbi ekzistencën e marrëdhënies së huas; -- ligji nr. 84/2016 dhe ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, nuk parashikojnë detyrim ligjor për të deklaruar në deklaratën vetting dhe as në DIPP, deklaratën për dhënie huaje të datës 01.10.2008, pasi nëna e bashkëshortes nuk përfshihet në kategorinë e subjekteve deklarues; -- z. A. M., sikurse konfirmohet edhe nga Komisioni ka pasur aftësi paguese për t'i dhënë vjehrrës huan në shumën 2.000.000 lekë.*
37. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të huas së marrë nga znj. H. H. prej z. A. M., në raport me argumentet e Komisionit në vendim, nga aktet e fashikullit të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

37.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, për të provuar marrëdhënien e huas me shtetasin A. M., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën e thjeshtë “Për dhënie huaje”, përmes të cilës z. A. M. në cilësinë e huadhënësit, deklaroi se në datën 01.10.2008, i jep hua shtetases H. H. shumën 2.000.000 lekë të reja, pa interes, me qëllim për të ndihmuar atë për nevoja ekonomiko-familjare. Znj. H. H. deklaroi marrjen e huas në shumën 2.000.000 lekë. Të dy deklaruesit deklarojnë se shuma e mësipërme do të kthehet nga huamarrësja, brenda 15 viteve nga data e huas.

37.2 Në vijim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur⁵²: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.07.2020 të znj. H. H., e cila deklaroi: “[...] kam marrë hua për nevoja ekonomike-familjare nga z. A. M., shumë në vlerën prej 2.000.000 lekësh. Këtë shumë e kam marrë pa akt noterial, me deklaratë për dhënie huaje të lidhur privatisht nga palët më datë 01.10.2008. Deklaroj se sot, më datë 17.07.2020, e kam likuiduar z. A. M. për të gjithë shumën e marrë hua, në vlerën prej 2.000.000 lekësh, shumë të cilën e kam likuiduar me bankë në llogarinë bankare të A. M., në Intesa Sanpaolo Bank ShA [...]”. Këto deklarime konfirmohen edhe nga shtetasi A. M.; (ii) mandat bankar në Intesa Sanpaolo Bank ShA, i datës 17.07.2020, për transferimin e shumës 2.000.000 nga H. H. tek A. M. me përshkrim: “kalim

⁵¹ Shih paragrafët 70 dhe 74 të vendimit të Komisionit.

⁵² Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorëve 3 dhe 5.

fondi sipas deklaratës për dhënie huaje dt. 01.10.2008, për qëllime ndihmëse ekonomike-familjare”.

37.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arriti në konkluzionin paraparak për të mos marrë në konsideratë mjetet financiare nga huaja e A. M., me arsyetimin se: [...] *ndonëse ka prova të kthimit të saj me transfertë bankare, - mbetet vetëm në nivel deklarativ për sa i përket fazës fillestare të marrëdhënies. Fakti që ky pretendim është ngritur për herë të parë në përgjigjet e dhëna nga subjekti të pyetësorit nr. 1, - gjatë procesit të rivlerësimit dhe që nuk ishte deklaruar më herët në deklaratat vjetore apo atë vetting, në këtë rast nuk mund të mos përbëjë në vetvete pengesë për ta konsideruar, pasi është burim i huadhënësës dhe jo direkt i subjektit. Gjithashtu, Komisioni, referuar deklaratës së dhënies së kësaj huaje, ka arritur në konkluzionin paraparak se shumica e dhënë hua nga z. A. M. ka pasur destinacionin për ndihmë ekonomike familjare për vjehrrën e subjektit, dhe jo për t’u dhënë hua prej saj në vijim, dhe se ky burim nuk është deklaruar nga subjekti mes burimeve të përdorura prej tij, për pagesat e pasurisë në analizë. Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës: “Duket se vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk ka patur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për të huazuar shumën e pretenduar”.*

37.4 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar: *Deklarata e huas është deklaruar nga ana ime në datën 19 korrik 2016, para inspektorit të ILDKPI-së. Në të njëjtën datë, unë kam depozituar tek inspektori dhe një kopje të deklaratës për dhënie huaje, të datës 01.10.2008, mes vjehrrës sime dhe z. A. M. Është e rëndësishme të theksohet se shpjegimet dhe dorëzimi i deklaratës së huas para inspektorit të ILDKPI-së janë kryer disa muaj para plotësimit të formularit të pasurisë në kuadër të rivlerësimit. Në këto kushte provohet qartë se nuk është i bazuar qëndrimi i Komisionit sipas të cilit kjo rrethanë është ngritur për herë të parë në përgjigjet e dhëna nga subjekti të pyetësorit nr. 1. Një rrethanë e tillë është pranuar edhe nga vetë Komisioni në të njëjtin paragraf të dokumentit “rezultatet e hetimit kryesisht...”. [...] Për këto arsye, në rastin e parë që më janë kërkuar shpjegime mbi këtë marrëdhënie, unë kam vënë në dispozicion dhe aktet përkatëse. [...] Është i vërtetë konstatimi i Komisionit se z. M. nuk ia ka dhënë huan vjehrrës sime me qëllim që kjo e fundit të ma jepte mua hua, por motivi i huas nuk ndryshon faktin se vjehrra ime e ka disponuar këtë shumë në datën kur më ka dhënë vlerën 2,000,000 lekë. Huaja është dhënë me dëshirën e mirë të z. M. për të mbështetur dhe plotësuar një nevojë të vjehrrës sime, e cila, që pas shitjes së dy pasurive në Peqin në dhjetor të vitit 2007, kishte menduar të zhvillonte një aktivitet ekonomik familjar në fushën e rrobaqepësisë. [...] Në deklaratën për dhënie huaje është përdorur shprehja “për nevoja ekonomike-familjare”. Këto fjalë me karakter të përgjithshëm janë përdorur për të shprehur zhvillimin e një biznesi familjar. Termi “ekonomik”, duke qenë se është një term me kuptim të gjerë, është përdorur për të shprehur kryerjen e një biznesi. Ndërkohë fjala “familjare” e përdorur në deklaratën për dhënie huaje, është shkruar pasi biznesi që synonte të fillonte vjehrra do të përdorej për të punësuar edhe pjesëtarë të tjerë të familjes. Vetë shumica e lartë prej 2,000,000 lekësh tregon se qëllimi i huas nuk ka qenë për konsum të përditshëm dhe se kjo vlerë është e përshtatshme për kryerjen e një investimi. [...] Deklarata e huas mes vjehrrës sime dhe z. A. M., e datës 01.10.2008, nuk është deklaruar nga ana ime gjatë plotësimit të formularit të pasurisë në kuadër të rivlerësimit dhe as në deklaratimet periodike të pasurisë, pasi nuk ekziston një detyrim ligjor për ta deklaruar këtë marrëdhënie. Unë kam qenë i detyruar të*

deklaroj vetëm marrëdhëniet që kam pasur personalisht me personat e lidhur dhe jo marrëdhëniet që këto të fundit kanë pasur me individë të tjerë.

38. Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të parashtruara më lart, në lidhje me marrëdhënien e huas mes znj. H. H. dhe z. A. M., në vlerësimin e trupit gjykues, pavarësisht paraqitjes së saj në formë shkresore të thjeshtë, si një formë e lejuar nga dispozitat e Kodit Civil për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së huas, lidhjes së saj mes dy subjekteve jo deklarues, si dhe mjaftueshmërisë së burimeve financiare të shtetasit A. M. për të dhënë hua në shumën 2.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë trupin gjykues se qëllimi i përdorimit të kësaj huaje ka pasur si destinacion dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur vetë kontrata e ka kufizuar destinacionin e përdorimit të saj “për nevoja ekonomike familjare” të huamarrëses, vjehrrës së subjektit të rivlerësimit. Në këto rrethana trupi gjykues vlerësoi të mos e përfshijë huan e pretenduar të shtetasit A. M. në analizën financiare të burimeve të ligjshme të huas së dhënë nga vjehrra, në vlerën 2.000.000 lekë.

Në lidhje me burimin “Të ardhura nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në Peqin”

39. Trupi gjykues vëren se Komisioni, konkluzionin e tij për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, huan e dhënë nga vjehrra në vitin 2009, e mbështet edhe në argumentin tjetër se të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në qytetin e Peqinit më datë 26.12.2007, mund të jenë disponuar më herët dhe të jenë përdorur nga ana e tyre për blerjen e pasurisë së ndodhur në qytetin e Durrësit (në datën 06.11.2007), nisur nga afati i shkurtër kohor mes blerjes së këtyre pasurive, si dhe në mungesë të burimeve alternative⁵³.
40. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni, në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, sipas të cilës, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së personave të lidhur, për sa kohë që ata nuk janë subjekte deklarues, duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, në rastin konkret e ka shkelur në mënyrë flagrante këtë standard, duke e shtrirë hetimin administrativ edhe në investime të tjera të vjehrrës, konkretisht në blerjen e banesës së ndodhur në Durrës. Komisioni ka vlerësuar në mënyrë alogjike nga pikëpamja kohore (shfaqur në një nivel ekstrem sa edhe ligjet e fizikës nuk kanë fuqi para tyre) dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore e kushtetuese si dhe standardeve të konsoliduara mbi analizimin e burimit të ligjshëm, dy kontratat e shitjeve nga vjehrra dhe vjehrrri, të dy pasurive të ndodhura në Peqin⁵⁴, të cilat janë kontrata noteriale të hartuara në formën e kërkuar nga ligji, dhe momenti i lidhjes së tyre është data kur për palët lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse, pra kalimi i të drejtave në këmbim të çmimit. Një vlerë monetare e marrë në fund të dhjetorit të vitit 2007, nuk mund të transportohet pas në kohë dhe të përdoret për një pagesë të kryer dy muaj më herët⁵⁵. Paligjshmëria e Komisionit thellohet akoma më tej*

⁵³ Shih paragrafin 75 të vendimit të Komisionit.

⁵⁴ Ky pretendim i referohet arsyetimit të Komisionit në vendim se “pavarësisht se kontratat e shitjes janë lidhur më datë 26.12.2007, kanë shërbyer për blerjen e një pasurie që është blerë më datë 06.11.2007, pra rreth dy muaj para se të kryhej shitja”.

⁵⁵ Në vendimin nr. {***}, datë 15.03.2002, Kolegji nuk ka marrë në konsideratë si burim huaje një kredi të marrë në një datë të mëvonshme.

kur nuk analizoi certifikatën për vërtetim pronësie dhe kartelën e pasurisë së apartamentit në Peqin, duke dëshmuar qartësisht se regjistrimi i kësaj prone në ZVRPP Peqin është kryer në datën 14.12.2007, dhe se në datën 06.11.2007, kur është hartuar deklarata për blerjen e apartamentit në Durrës, shtëpia e prindërve të bashkëshortes në Peqin, nuk ishte ende e regjistruar.

41. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni në lidhje me të ardhurat nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në Peqin, trupi gjyqës konstaton se:

41.1 Gjatë hetimit administrativ, për të provuar të ardhurat nga shitja e dy pasurive të paluajtshme nga prindërit e bashkëshortes në qytetin e Peqinit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur⁵⁶ aktet si vijojnë:

- Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2007, të lidhur mes shtetasve Sh. H., H. H. dhe A. D. (H.) në cilësinë e palës shitëse në njëren anë, dhe shtetas M. B. në cilësinë e palës blerëse në anën tjetër, me objekt pasurinë nr. {***}, “*Apartament me sipërfaqe totale 46.7 m²”, nga ku 14.42 m² janë truall dhe 46.7 m² i zë ndërtesa ndodhur në lagjen “{***}”, Peqin, në vlerën 1.000.000 lekë të reja në total, shumë e cila është likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësve jashtë zyrës së noterisë dhe sipas pohimit të palëve, ato nuk kanë detyrime reciproke me njëri tjetrin.*

- Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2007, të lidhur mes shtetasit Sh. H. në cilësinë e shitësit dhe shtetas M. B. në cilësinë e blerëses, me objekt pasurinë me nr. {***}, e cilësuar “*Shtesë pallati*” me sipërfaqe 7.35 m², në lagjen “{***}”, Peqin, në vlerën 500.000 lekë të reja në total, shumë e cila është likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësit, jashtë zyrës së noterisë, dhe sipas pohimit të palëve, ato nuk kanë detyrime reciproke me njëri tjetrin.

41.2 I pyetur në vijim të hetimit administrativ, mbi vendbanimin e vjehrrës H. H. pas shitjes së apartamentit në qytetin e Peqinit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁵⁷ se: *Vjehrrri dhe vjehrra ime kanë marrë në posedim dhe kanë jetuar në një apartament me sipërfaqe 54 m², të ndodhur në lagjen nr. {***}, rruga “{***}”, i cili i përkiste shtetas V. T.. Ndërmjet vjehrrit tim Sh. H. dhe përfaqësueses së znj. T., është hartuar deklarata noteriale nr. {***} rep., dhe {***} kol./{***}, dt. 06.11.2007, me të cilën familja e vjehrrit tim ka përfitur të drejtat reale (në deklaratë palët janë shprehur për shitje, por prona nuk ka qenë e regjistruar në ZVRPP) mbi apartamentin e mësipërm. Lidhur me këtë pronë, nuk është lidhur kontrata e shitblerjes pasi pallati ende nuk është regjistruar në ZVRPP (aktualisht, ASHK). Dy muaj pas posedimit të apartamentit dhe pas deklaratës së mësipërme noteriale, është kryer shitja e apartamentit dhe dyqanit të ndodhur në Peqin. Në këtë mënyrë është siguruar shuma prej 1.5 milionë si rezultat i shitjes së pasurive. Kjo shumë është poseduar nga vjehrra ime në momentin që më ka dhënë hua shumë 2 milionë lekë në datën 21.2.2009. Ajo ka pasur mundësi financiare për të më dhënë huan në shumë e mësipërme, pasi veç vlerës së siguruar nga shitja e pasurive, ajo kishte*

⁵⁶ Në përgjigje të pyetësorit standard.

⁵⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7.

marrë hua dhe një shumë prej 2 milionë lekësh nga shtetasi A. M.. [...]. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet si vijojnë:

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol./{***} kol., datë 06.11.2007, e shtetasve Dh. F., në cilësinë e përfaqësueses me prokurë, dhe shtetas V. T., e cila deklaron: [...] *i kam shitur z. Sh. H., një apartament banimi me sipërfaqe 54 m², kati i parë i banimit, i cili ndodhet në lagjia nr. {***}, rruga “{***}”, i cili është në pronësinë e V. T. Shuma për këtë shitblerje është caktuar 3.250.000 lekë. Sot në datën 06.11.2007, unë, Dh. F., kam marrë në dorëzim shumën prej 3.000.000 lekësh dhe diferenca prej 250.000 lekësh do të paguhet nga z. Sh. H. në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes noteriale nga pronarja e apartamentit”, dhe shtetasit Sh. H., i cili deklaron: [...] *e kam dorëzuar shumën e mësipërme dhe jam dakord me dorëzimin e diferencës në momentin e nënshkrimit të kontratës noteriale.**

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2023, e shtetas H. H., përmes të cilës deklarohet: *Në vitin 2007, jam transferuar në qytetin e Durrësit, ku kemi marrë në posedim një apartament me sipërfaqe 54 m², të ndodhur në lagjen nr. {***}, rruga “{***}”, që i përkiste shtetas V. T. Në datën 06.11.2007, bashkëshorti im ka hartuar një deklaratë noteriale me përfaqësuesen e znj. T., ku konfirmohet se në atë datë bashkëshorti ka paguar shumën 3.000.000 lekë për shitjen e apartamentit ndërsa diferenca prej 250.000 lekësh do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Kjo pronë nuk ka qenë dhe nuk është ende e regjistruar pranë AShK-së, e për këtë shkak, deri në këtë moment nuk është lidhur kontrata e shitblerjes. Shuma prej 3.000.000 lekësh është paguar nga kursimet e krijuara nga puna ime si rrobaqepëse dhe tregtare në Peqin e produkteve të përgatitura prej meje. [...] Në datën 26.12.2007, unë, bashkëshorti im dhe vajza ime, kemi shitur shtëpinë dhe dyqanin ku unë punoja si rrobaqepëse, të cilat ndodheshin në Peqin. Ditën e shitjes së këtyre pasurive ne kemi marrë edhe vlerat përkatëse të shitblerjes që arrijnë në shumën 1.500.000 lekë. Kjo shumë është kursyer nga familja ime, pasi shpenzimet e jetesës mbuloheshin nga puna si rrobaqepëse. Në vitin 2009, i kam dhënë hua dhëndrit tim shumën prej 2.000.000 lekësh, të cilën e posedoja në banesë. Në kohën e dhënies së huas, unë kam pasur në shtëpi një vlerë totale prej 3.500.000 lekësh, ku 1.500.000 lekë i kisha siguruar nga shitja e pasurive dhe një vlerë prej 2.000.000 lekësh i kisha marrë hua nga z. A. M.. Nga e gjithë kjo shumë, i kam dhënë hua dhëndrit tim, A., vlerën 2.000.000 lekë, pasi ai dhe vajza ime më kërkuan t’i ndihmoja financiarisht për nevoja të tyre. [...].*

- Certifikatë për vërtetim pronësie, lëshuar më datë 14.12.2007, sipas të cilës figuron e regjistruar në pronësi të Sh., H. dhe A. H. apartamenti me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 46.7 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Peqin. Sipas kartelës së pasurisë bashkëlidhur, kjo pasuri rezulton e regjistruar më datë 22.03.2000, kurse certifikata është lëshuar më datë 14.12.2007, dhe adresa e pronarit është në “Durrës”.

- Vërtetim nga dokumentet hipotekore të datës 04.12.2003, sipas të cilit figuron i regjistruar në emër të Sh. H., pasuria nr. {***}, “shtesë pallati”, ndodhur në lagjen “{***}”, Peqin, me sipërfaqe 7.35 m².

41.3 Nga informacionet e përcjella gjatë hetimit administrativ nga Zyra Vendore e AShK-së Peqin,⁵⁸ rezulton se shtetasit Sh. H. dhe H. Ç., nuk kanë pasuri të paluajtshme të regjistruara në këtë zyrë.

41.4 Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit ndër të tjera edhe dyshimin se të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme në qytetin e Peqinit mund të jenë disponuar nga prindërit e bashkëshortes më herët, dhe të jenë përdorur për blerjen e pasurisë së ndodhur në qytetin e Durrësit. Ky dyshim është argumentuar me afatin e shkurtër kohor mes blerjes së pasurisë në Durrës dhe shitjes së dy pasurive të ndodhura në Peqin, duke i kaluar barrën e provës: “*Duket se vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk ka mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për të huazuar shumën e pretenduar*”.

41.5 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: [...] *Qëndrimi i Komisionit nuk është i mbështetur në prova e për pasojë duhet të rishikohet, bazuar në rrethanat e mëposhtme: -- shitja e dy pasurive të ndodhura në qytetin e Peqinit ka ndodhur më datë 26.12.2007, pra saktësisht një muaj e 20 ditë pas pagimit në datë 06.11.2007 të shumës për apartamentin e ndodhur në Durrës. – Sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2007, lidhur me pronën e ndodhur në qytetin e Durrësit, shuma për përfitimin e të drejtave mbi këtë pasuri është paguar në datën e hartimit të kontratës, pra , 06.11.2007; dyshimi i ngritur nga Komisioni se paratë nga shitja e dy pasurive në Peqin mund të jenë disponuar më herët dhe të jenë përdorur për blerjen e pasurisë së ndodhur në qytetin e Durrësit, nuk bazohet në ndonjë akt, informacion apo të dhënë konkrete; -- dy kontratat e datës 26.12.2007 janë kontrata noteriale të hartuara në formën e kërkuar nga ligji dhe blerësi paguan çmimin përkatës të blerjes duke përfituar në këmbim pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme -- nuk është e bazuar të mendohet se një person mund të paguajë një vlerë prej 1.500.000 lekësh, e në vijim të presë për një kohë prej dy muajsh për të lidhur kontratën e shitblerjes së pasurive. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur këtyre shpjegimeve edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.04.2023, të shtetasës Dh. F., e cila kishte vepruar si përfaqësuese ligjore e shtetasës V. T. në hartimin e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2007, e cila konfirmon deklarin e bërë në deklaratën noteriale se shuma prej 3.000.000 lekësh për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 54 m,² në Durrës, i është paguar në ditën e hartimit të deklaratës noteriale.*

42. Nga analizimi i fakteve parashtruara më lart, trupi gjykues vëren se përmes dy kontratave të shitblerjes të datës 26.12.2007 prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë përfituar në total të ardhura në shumën 1.500.000 lekë nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në qytetin e Peqinit në datë 26.12.2007, përkatësisht 1.000.000 lekë nga shitja e një apartamenti me sipërfaqe 46.7 m² dhe 500.000 lekë nga shitja e një shtese pallati me sipërfaqe 7.35 m². Në vlerësim të dokumentacionit ligjor, trupi gjykues nuk gjen ndonjë lidhje logjike e të arsyeshme, që këto të ardhura të kenë shërbyer për blerjen e apartamentit në Durrës, në një datë më të hershme, më 06.11.2007, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2007. Në këto rrethana, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë ndonjëherë e lidhur me detyrim deklarimi pasurie, trupi gjykues

⁵⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.08.2020.

arriti në konkluzionin se shuma prej 1.500.000 lekësh duhet të përfshihen në analizën financiare të burimeve të huas së dhënë nga znj. H. H., në masën e pjesës takuese të prindërve, përlllogaritur në shumën 961.737 lekë⁵⁹. Në përlllogaritjen e kësaj vlere, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin se referuar certifikatës për vërtetim pronësie të apartamentit me sipërfaqe 46.7 m², në cilësinë e bashkëpronares me pjesë takuese 1/3, figuron edhe e motra e bashkëshortes së subjektit, znj. A. H. (D.), si dhe faktin se nuk rezulton ndonjë akt që ajo të ketë hequr dorë nga bashkëpronësia.

43. Veç sa më lart, trupi gjykues, nga kontrolli i përmbajtjes së vendimit, vëren se Komisioni, konkluzionin e tij për të mos e përfshirë huan e marrë nga znj. H. H. në mesin e të ardhurave për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, e ka mbështetur së fundi edhe në argumentin se nga subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë dokument ligjor për burime të ardhurash nga punësime të mundshme të vjehrrës apo vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, që të kënaqë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përpos fotografive dhe deklarimeve lidhur me aktivitetin e ushtruar nga znj. H. H. si rrobaqepëse.
44. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se: *Pavarësisht pamundësisë për të provuar vlerat monetare të siguruara nga vetëpunësimi i vjehrrës si rrobaqepëse për shkak të kohës së largët dhe natyrës artizanale të aktivitetit, ai ka provuar përpara Komisionit ushtrimin në vazhdimësi të profesionit të rrobaqepëses, prej të cilit janë siguruar të ardhurat e nevojshme për blerjen më datë 06.11.2007, të banesës në Durrës. Komisioni nuk ka analizuar fotografitë e depozituara lidhur me ushtrimin e profesionit të rrobaqepëses.*
45. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

45.1 I ftuar gjatë hetimit administrativ për të paraqitur dokumentacion mbi të ardhura të vjehrrës nga punësimi apo aktivitete private, duke specifikuar periudhën e punësimit apo aktivitete të mundshme tregtare deri në shkurt të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁶⁰ [...] *me gjithë kërkimet e kryera, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk është mundur të sigurohen të dhënat e kërkuara, konkretisht dokumentet e lëshuara nga Bashkia Peqin, lidhur me këtë fakt. Sa i takon ushtrimin të profesionit të rrobaqepëses, bashkëlidhur ju vihen në dispozicion foto të vjehrrës sime gjatë ushtrimit të këtij profesioni deri në vitin 2007 në Peqin, dhe pas atij viti në qytetin e Durrësit.* Subjekti i ka shoqëruar këto shpjegime me 9 fotografi në të cilat evidentohen pamje nga një aktivitet rrobaqepësie.

45.2 Në vijim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një tjetër deklaratë noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2023, të shtetases H. H., në të cilën ndër të tjera ajo deklaron: [...] *Jam me profesion rrobaqepëse, profesion të cilin e kam ushtruar gjatë gjithë jetës sime dhe vazhdoj ta ushtrroj edhe aktualisht. Deri në vitin 2007, kam qenë banore e Bashkisë Peqin, ku kam punuar si rrobaqepëse dhe në të njëjtën kohë kam tregtuar në tregun industrial të Bashkisë Peqin veshjet e përgatitura nga ana ime. Për tregtimin e veshjeve në treg*

⁵⁹ Shumës totale prej 1.166.667 lekësh (500.000 lekë të përfituara nga shitja e shtesës së pallatit dhe 666.667 lekë të përfituara nga shitja e apartamentit) të pjesës takuese të prindërve nga shitja e apartamenteve, i janë zbritur shpenzimet e jetesës së tyre për periudhën janar 2008 – shtator 2008.

⁶⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

kam paguar edhe taksat ditore, pagesë e cila kryhej çdo ditë përkundrejt biletës përkatëse ditore. Nga puna si rrobaqepëse dhe tregtimi i produkteve që prodhoja deri në vitin 2007, kam mbuluar të gjitha shpenzimet e jetesës dhe kam mundësuar krijimin e kursimeve të nevojshme financiare. [...] Pas transferimit të familjes tonë në Durrës, unë kam vazhduar të punoj si rrobaqepëse artizanale, profesion që e ushtruj edhe aktualisht. Edhe pas kësaj periudhe, shpenzimet e jetesës janë mbuluar nga puna ime si rrobaqepëse. Pasi unë dhe bashkëshorti im kemi dalë në pension, shpenzimet janë mbuluar edhe me vlerat e pensionit. [...].

45.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit me konkluzionin paraprak, se nuk është provuar burimi i të ardhurave nga punësime të mundshme të vjehrrës apo vjehrrit të tij që do të kënaqte kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përveç fotografive dhe deklarimeve lidhur me aktivitetin e ushtruar nga znj. H. H. si rrobaqepëse. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti nuk ka dhënë shpjegime shtesë apo të këtë paraqitur prova lidhur me këto të ardhura.

46. Bazuar në sa më lart, në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, sa i takon të ardhurave të pretenduara të vjehrrës nga aktiviteti privat si rrobaqepëse, në vlerësimin e trupit gjykues, ndonëse evidentohen gjurmë të ushtrimit të këtij aktiviteti që në kohë të hershme, sikurse arsyetuar edhe në paragrafin 18 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhura të realizuara nga ky aktivitet në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
47. Në përfundim të analizës së burimeve të krijimit të shumës prej 2.000.000 lekësh, e dhënë hua subjektit nga huadhënësja H. H., trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe pas korrektimit të mësipërm, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së subjektit, të realizuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në qytetin e Peqinit, në vlerën e pjesës së tyre takuese, subjekti i rivlerësimit rezulton sërish me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit në vitin 2009.
48. Veç sa më lart, në funksion të verifikimit të burimeve të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *rezultati i analizës financiare për vitin 2010 është arbitrar dhe i pambështetur në prova, argumentuar me faktin se, për pagimin e këstit të fundit prej 600.000 lekësh janë përdorur 500.000 lekë nga kursimet e pavarura të nënës, si dhe pjesa tjetër nga kursimet cash të tij dhe bashkëshortes mbi 400.000 lekë cash, të krijuar nga tepricat e viteve 2007 dhe 2008 që i është bashkuar vlerave monetare të disponuara në vitin 2010. Sipas tij, vetëm gjatë viteve 2006 – 2008 nëna e tij ka kursyer nga pensioni shumë prej 410.310 lekësh, të cilën e ka administruar vetë, dhe përveç këtyre të ardhurave, ajo ka kursyer edhe shumat e dërguara nga dy fëmijët emigrantë, në formën e ndihmës ekonomike, të cilat provohen me deklaratat noteriale të vëllait M. B. dhe të motrës M. K., ndërkohë që ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar të dhëna nga Western Union. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kursimet e nënës nga pensioni dhe dhurimet e vëllait dhe motrës, nuk janë deklaruar si në DIPP ashtu dhe në deklaratën vetting pasi nuk ka qenë detyrim ligjor as sipas ligjit nr.9049/2003 e as sipas ligjit nr.84/2016. Ndërkohë që për shkak të paqartësive në deklaram nuk i ka përfshirë në DIPP-të përkatëse as kursimet cash të viteve 2007 dhe 2008 nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.*

49. Komisioni, në vendim ka arritur në konkluzionin “Komisioni, pasi ka përlllogaritur të ardhurat e ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie, në raport me shumën e shpenzuara dhe shpenzimet jetike, ka rezultuar një pamundësi financiare në vlerën -1.852.606 lekë, siç ishte njoftuar më herët në rezultatet e hetimit, përkatësisht -1.510.053 lekë në vitin 2009 dhe -342.552 lekë në vitin 2010.

50. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

50.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, ndër burimet e krijimit të pasurisë apartament të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 12.05.2010, mbi bazën e kontratës së porosisë nr. {***}, datë 12.05.2009, ka deklaruar edhe kursimet familjare, të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të fundit në vlerën 600.000 lekë. -- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “1. Shtuar apartament, nr. {***}, ZK {***}, sip. 61 m², rr. ‘{***}’, çmimi 4.000.000 lekë. Kontrata e shitblerjes {***}, dt. 15.12.201, e cila është lidhur në bazë të kontratës së porosisë {***}, dt.12.05.2009. Paguar 600.000 lekë”, si dhe “2. Pakësuar 600.000 lekë në bazë të kontratës së shitblerjes nr. {***}, dt. 15.12.2011”. Nuk deklarohet burimi i krijimit të shumës së pakësuar prej 600.000 lekësh.

50.2 Nga verifikimi i DIPP-ve, për vitet 2006 – 2009, konstatohet se: (i) në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar “Shtuar 270.000 lekë”, pa specifikuar nëse bëhet fjalë për shtim të likuiditetit *cash* apo në llogari bankare. Në rubrikën e të ardhurave të kësaj deklarate, deklarohen të ardhura nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij; (ii) në DIPP-të 2007 – 2008, nuk deklarohen shtesa/pakësime të gjendjes *cash*. Në rubrikën të ardhurave deklarohen të ardhurat nga puna e subjektit, bashkëshortes, si dhe pensioni i nënës.

50.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit konkluzionin paraprak, se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2010, ka rezultuar se, për të kryer pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit, si dhe për të mbuluar shpenzimet e familjes gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën – 342.552 lekë. Për këto arsye, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës: “Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare – 1.510.053 lekë, në vitin 2009, si dhe në vlerën – 342.552 lekë në vitin 2010, për të paguar çmimin e blerjes së apartamentit në analizë dhe për të mbuluar shpenzimet e viteve përkatës”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, njësoj si në ankim, ka pretenduar se në këtë analizë nuk janë përfshirë disa të ardhura dhe kursime të krijuara nga nëna e tij si kursime të saj (nga pensioni dhe dhurime të vëllait dhe motrës), si dhe kursimet *cash* që ai dhe bashkëshortja kanë pasur gjatë viteve, të cilat nuk janë deklaruar prej tij.

51. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kursime të pavarura të nënës në shumën 500.000 lekë (shuma prej 410.310 lekësh e kursyer nga pensioni gjatë viteve 2006 – 2008 dhe shumën e dërguara nga dy fëmijët emigrantë), nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, rezulton se në kuadër të ekonomisë familjare të përbashkët, të ardhurat e përfituara nga pensioni i nënës për vitet 2006 – 2008 janë përfshirë në analizën e këtyre viteve. Në këto rrethana, duke përdorur të njëjtin arsyetim si në paragrafin 26 më lart, trupi gjykues i

gjen të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me kursime të pavarura të nënës, në shumën 500.000 lekë për periudhën 2006 – 2008. Edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi disponimin e kursimeve *cash* të viteve 2007 dhe 2008 nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, të padeklaruara në deklaratat e interesave private periodike respektive, në vlerësimin e trupit gjykues mbeten deklarative, e si të tilla, nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve për pagesën e këstit të fundit të apartamentit prej 600.000 lekësh.

52. Në konkluzion të analizimit të saktësisë së deklaramit dhe kontrollit të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë “*Apartament banimi me sipërfaqe 61 m²”, në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën -1.380.816 lekë⁶¹ për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5 shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

Në lidhje me analizën financiare

53. Përveç pretendimeve të trajtuara më sipër që afektojnë analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim edhe rezultatin e analizës financiare për vitin 2006, duke e konsideruar të gabuar, për shkak se në këtë vit është konsideruar shtimi i kursimeve *cash* me vlerën 270.000 lekë, ndërkohë që në DIPP-në e atij viti nuk specifikohet që kjo shumë është *cash*, por shtesa e deklaruar ka qenë në llogarinë e tij bankare, jo në fund të vitit, por në momentin e deklaramit.
54. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit, vëren fillimisht se Komisioni ka arritur në konkluzionin:⁶² “*Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të pagës, nuk ka rezultuar e shtuar vlera e pretenduar nga subjekti, as në fund të vitit 2006 dhe as gjatë muajve të parë të vitit 2007. Në këto kushte, pretendimi i subjektit është konsideruar i pabazuar*”. Në kontroll të këtij konkluzioni, trupi gjykues, referuar ligjit nr. 9049/2003 dhe formularit të deklaratës respektive, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar ndryshimet (shtesa/pakësime) në vlerën e likuiditeteve, *cash* apo në llogari rrjedhëse a depozitë, nga deklarimi i mëparshëm deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklaramit, dhe jo në momentin e plotësimit të deklaratës. Në rastin konkret, nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2006, trupi gjykues vëren se në rubrikën e dedikuar për deklarimin e ndryshimeve (shtesa ose pakësime) në interesat pasurore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “Shtuar 270.000 lekë”, pa specifikuar nëse bëhet fjalë për shtim likuiditeti *cash* apo në bankë. Ndërkaq, nga verifikimi i llogarisë së pagës së subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank ShA, nuk rezulton gjendje apo shtesë në vlerën 270.000 lekë, si në fund të vitit 2006, ashtu edhe në fillim të vitit 2007. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë edhe konkluzionin e Komisionit që ka konsideruar si likuiditet *cash* për vitin 2006 vlerën prej 270.000 lekësh të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave periodike private të vitit 2006, e për pasojë edhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme të vitit 2006, në kushtet kur nga verifikimi i llogarisë së pagës

⁶¹ Shuma prej -1.380.816 lekësh përbëhet nga: (i) mungesa e burimeve financiare të ligjshme në shumën -1.038.263 lekë, për pagesën e shumës 4.000.000 lekë, më datë 12.05.2009 dhe (ii) mungesa e burimeve financiare të ligjshme në shumën -342.552 lekë, për pagesën e shumës 600.000 lekë, më datë 15.12.2010.

⁶² Shih paragrafin 159 të vendimit të Komisionit.

në bankë, nuk rezulton gjendje apo shtesë në këtë vlerë qoftë në fund të vitit 2006, qoftë në fillim të vitit 2007.

55. Nga kontrolli i analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën prej - 1.731.815 lekësh. Trupi gjykues çmon se, në këtë mungesë burimesh financiare të ligjshme nuk është përfshirë efekti financiar i shumës së marrë hua nga z. F. Sh., e cila, siç do të trajtohet në vijim, është konsideruar si një marrëdhënie huamarrje e pabesueshme, e ndërtuar dhe zhvilluar në mungesë të një logjike ekonomike. Në kushtet kur kjo çështje në Kolegj u shqyrtua në bazë të ankimit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, nuk korrigjoi analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, por efektin që do të rezultonte nga mospërfshirja e kësaj shume si me burime të ligjshme, e mbajti në konsideratë në drejtim të konkluzionit për kontrollin e kriterit të pasurisë.
56. Trupi gjykues i Kolegjit, për kontrollin e kriterit të pasurisë, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

III. Lidhur me një investim të bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK

57. Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin⁶³ se: “[...] në konkluzion të vlerësimit të kësaj marrëdhënieje juridiko-financiare, Komisioni çmon se sjellja e subjektit, dinamika në kohë e vetë marrëdhënies de qua, si dhe kushtet dhe rrethanat në të cilat është krijuar dhe zhvilluar kjo marrëdhënie interesi, krijon bindjen se e gjithë kjo situatë është krijuar në mënyrë artificiale, për të evituar verifikimin e burimeve reale, duke tentuar fshehjen e gjurmëve të investimit të vërtetë. Në këto kushte, pavarësisht se huadhënësi, z. Sh., ka pasur aftësi huadhënëse, kjo nuk i justifikon veprimet, mosveprimet dhe pritshmëritë e mëtejshme të subjektit të rivlerësimit, e për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se z. Armand Gurakuqi ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe se ai, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut, e për pasojë, në këtë rast duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë shkarkimin e subjektit nga detyra”.
58. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se Komisioni, në vlerësimin e marrëdhënies së bashkëshortes me shoqërinë “{***}” ShPK, dhe burimin e saj që është huaja në vlerën 75.000 euro e marrë nga shtetasi F. Sh., ka vepruar në shkelje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, neneve 31, 32, pika 4, 33, pika 5, nenit 61, pika 5, dhe me standardet e vendosura nga Kolegji dhe Komisioni. Në mbështetje të këtij shkakut ankimor, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet e argumentet si më poshtë:

58.1 Komisioni nuk ka analizuar provat e administruara⁶⁴, dhe është bazuar vetëm në hamendësime e interpretime arbitrare, të cekëta, të cinguar dhe të njëanshme, të rrethanave

⁶³ Shih paragrafin 146 të vendimit të Komisionit.

⁶⁴ Kontratën e huas së datës 18.09.2012, hartuar para noterit; shkresën e datës 23.02.2023 të noterës që e ka konfirmuar kontratën e huas; tri kontratat e shitblerjes së datës 20.12.2011, për shitjen e tre pasurive nga shtetasi F. Sh.; llogaritë dhe veprimet bankare të shtetasit F. Sh. deri në momentin e dhënies së huas; DIPP-të 2012 - 2016 dhe deklaratën vetting; dëshminë e shtetasit F. Sh.; shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

të kësaj marrëveshjeje, pasi nuk ka asnjë të dhënë, nga asnjë dokument, dëshmitar apo informacion, qoftë edhe indirekt, që shuma e investuar nga bashkëshortja e tij të ketë rrjedhur nga një burim i paligjshëm, ndërkohë që DSIK-ja ka konfirmuar pastërtinë e figurës dhe është arritur një nivel kualifikues në aftësitë profesionale.

58.2 Marrëdhënia mes tij dhe huadhënësit është një marrëdhënie e mirë miqësie, e bazuar në besim dhe respekt reciprok, dhe se Komisioni, megjithëse ka provuar qartësisht mungesën e konfliktit të interesit me huadhënësin F. Sh., nuk ka analizuar edhe një rrethanë tjetër të rëndësishme, se z. Sh. i ka ndihmuar edhe në vitin 2007, kur vendosi në hipotekë banesën e tij për marrjen e një kredie nga subjekti në vitin 2007.

58.3 Huadhënësi F. Sh. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve financiare për dhënien e huas në shumën 75.000 euro bashkëshortes së subjektit.

58.4 Komisioni ka anashkaluar arsyen fillestare për të cilën ishte e nevojshme marrja e huas te shtetasi F. Sh., qëllimin për të marrë pjesë në një investim sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me shoqërinë “{***}” ShPK, projekt që ishte parë ndër të tjera edhe si nevojë për të shlyer dy huat që ishin marrë më parë nga vjehrra dhe A. B.. Në kushtet kur, me gjithë interesimet, sipas subjektit, nuk ishte bërë e mundur marrja e një kredie bankare në vlerën e mësipërme, e vetmja mundësi financiare për të marrë pjesë në investim, ishte marrja e huas tek z. Sh.

58.5 Komisioni, nisur nga njëanshmëria dhe paragjykimi i kontratës së huas, ka zgjedhur të mos analizojë dhe të përjashtojë nga vlerësimi i provave ndikimin që mosrealizimi i investimit nga shtetasi Z. Z. ka pasur në vonesën e kthimit të huas nga bashkëshortja e tij tek shtetasi F. Sh., pasi nëse do të përmbusheshin detyrimet nga “{**}” ShPK, huaja do të ishte shlyer që prej vitit 2015, ose më së shumti në momentin e përcaktimit dhe akordimit të marzhit të fitimit që i përkiste bashkëshortes, por ky detyrim, jo vetëm që nuk u plotësua në asnjë moment nga shtetasi Z. Z., por edhe vetë shuma e huas që kishte shërbyer si burim i investimit nuk u kthye prej këtij personi.

58.6 Vetë Komisioni pranon se, si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve nga shoqëria “{***}” ShPK, bashkëshortja e tij nuk ka përfituar të drejtat ekonomike të paraqitura në kontratën e huas, pasi nuk ka rezultuar asnjë pagesë e kryer nga shoqëria “{***}” ShPK apo z. Z. në favor të saj, të cilat nëse do të ishin përfituar, do të ishin të ligjshme dhe do të ishin deklaruar pranë ILDKPKI-së;

58.7 Pritshmëritë e Komisionit, që bashkëshortja e tij duhej që në vitin 2012 të kishte paraparë të ardhmen që shtetasit F. Sh. dhe Z. Z. do të kishin çështje penale në vijim, është në kundërshtim me limitet e funksionimit të qenies njerëzore e për pasojë kurrsesi nuk duhet të lejohet të shërbejë si bazë për marrjen e masës ekstreme disiplinore ndaj një magjistrati.

58.8 Sa i takon ekzistencës së çështjeve penale ndaj shtetasit F. Sh., kjo e dhënë është paraqitur në mënyrë të rreme në vendimin objekt ankimi, pasi dhe vetë Komisioni ka konfirmuar se ky person është pyetur vetëm në cilësinë e deklaruesit. Ndërkohë Komisioni ka paraqitur në mënyrë të cunguar në vendim të dhënat në lidhje me shtetasin Z. Z., të cilat janë regjistruar në

vitin 2021, pra pothuaj pas 10 vitesh, sikurse pasqyrohet në rezultatet e hetimit. Komisioni nuk ka përfshirë në vendim elemente të rëndësishme lidhur me shtetasin Z. Z., lidhur me dënimin e tij për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i KP. Një mungesë e tillë përgjegjshmërie ligjore është shfaqur nga shtetasi Z. Z. edhe në dëm të bashkëshortes së tij.

59. Nga kontrolli i arsytimit të vendimit, trupi gjykues vëren fillimisht se, Komisioni, megjithëse ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës pasi ka tentuar fshehjen e gjurmëve të investimit të vërtetë, nuk i ka atribuar atij pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016⁶⁵, por e ka kualifikuar atë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si cenim të besimit të publikut. Në këtë konkluzion Komisioni ka arritur pasi ka analizuar veprimet e subjektit të rivlerësimit, si në drejtim të marrëdhënies së huas me shtetasin F. Sh., pavarësisht mjaftueshmërisë së burimeve financiare të tij për të dhënë hua, ashtu dhe në drejtim të marrëveshjes së bashkëpunimit/investimit të bashkëshortes së tij me shoqërinë “{***}” ShPK dhe ortakun e saj Z. Z., me burim huan e pretenduar nga shtetasi F. Sh.
60. Konkretisht, në drejtim të marrëdhënies së huas me shtetasin F. Sh., Komisioni ka evidentuar në funksion të konkluzionit të tij mbi cenimin e besimit të publikut, një sërë rrethanash të cilat ngrenë dyshime mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje, ndër të cilat: (i) marrja nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit të një huaje nga një biznesmen, për të investuar në zhvillimin e një projekti ndërtues nga një tjetër biznesmen, duke mos investuar asnjë shumë nga paratë/kursimet e veta; (ii) marrja e një huaje në vlerën 75.000 euro, afatgjatë dhe pa interes, për ta investuar për të përfituar të ardhura, i konsideruar nga Komisioni si një veprim i kryer në mungesë të një logjike ekonomike; (iii) investimi në mënyrë të përsëritur, duke përdorur mjete monetare të huazuara, në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti, madje në këtë rast investimi është kryer totalisht me burim financiar të përfituar nga një hua; (iv) pretendimi se investimi i kryer është financiar me bujari nga z. Sh. nëpërmjet huadhënies prej 75.000 eurosh, është konsideruar jo bindës pasi ky i fundit përpos disponibilitetit financiar të përkohshëm, nuk mund të privonte biznesin e vet për një kohë relativisht të gjatë (5-10) vjet, nga një shumë e konsiderueshme monetare, pa përfituar asnjë interes (madje duke i paguar interesa bankës për marrjen, më pas, të kredive për të investuar në bizneset e veta); (v) kthimi i huas është realizuar pas deklaratës së pasurisë *vetting*, gjatë kryerjes së verifikimeve nga Komisioni; (vi) në deklaratën e pasurisë *vetting* rezulton e deklaruar një gjendje *cash*-i, megjithëse ndodheshin në disa situata huamarrjeje ende të pashlyera nga vitet më parë.
61. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, fillimisht në drejtim të besueshmërisë së marrëdhënies së huas me shtetasin F. Sh., trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të hetimit administrativ, si dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si vijon:
- 61.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës së personit të lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Detyrim huaje ndaj z. F. Sh., 75.000*

⁶⁵ Në tabelën e analizës financiare për periudhën 2003-2016, në faqen 41 të vendimit, është përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme për vitin 2012, huaja e marrë nga shtetasi F. Sh., në vlerën 75.000 euro, konvertuar në 10.479.000 lekë.

euro, në bazë të kontratës nr. {***}, dt. 18.09.2012, notere M. Ll., për të cilën nuk është shlyer asnjë vlerë. Burimi i parave kanë shërbyer tri kontratat e shitblerjes së pasurisë nga shtetasi F. Sh. me nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.12.2011; nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.12.2011, dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.12.2011”. Po në këtë rubrikë, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Marrëveshje bashkëpunimi dt.16.10.2012 lidhur mes G. G. dhe Z. Z. si përfaqësues i shoqërisë “{***}”, për investimin e shumës 75.000 euro, në ndërtimin që shoqëria “{***}” është duke kryer në bazë të lejeve të ndërtimit nr. {***} prot., dt.21.08.2012; nr.{***}, dt.27.09.2011 dhe nr. {***} prot., dt. 21.08.2012, të ish-Komunës Dajt. Vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 16.10.2012, notere G. Sh.”. Për të dokumentuar marrëdhënien e bashkëpunimit/investimit me shoqërinë “{***}” ShPK dhe burimin e ligjshëm të shumës së investuar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur kësaj deklarate, ndër të tjera⁶⁶ edhe:

- Marrëveshje bashkëpunimi e datës 16.10.2012, me vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2012, e lidhur në zyrën e shoqërisë “{***}” ShPK, mes palës së parë Z. Z. (K.), ortak pranë shoqërisë investitore “{***}” ShPK, dhe palës së dytë G. G., në të cilën parashikohet se dy palët bien dakord që shtetasja G. G., e cila disponon mjete monetare, konkretisht 75.000 euro, të cilat i ka siguruar nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.09.2012, të kontribuojë financiarisht në investimin e ndërtimit të dy objekteve për të cilat janë akorduar lejet e ndërtimit, shumën 75.000 euro, e paguar jashtë zyre.
- Kontratë huadhënie nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 18.09.2012, e lidhur mes F. Sh.⁶⁷ në cilësinë e huadhënësit dhe G. G. në cilësinë e huamarrëses. Në këtë kontratë përcaktohet se: “Huadhënësi i ka dhënë huamarrësit një shumë prej 75.000 eurosh. [...] Huamarrësi deklaron se shumën prej 75.000 eurosh do ta kthejë më datë 05.09.2017. Vlera e mësipërme jepet hua për një periudhë kohore për 5 vjet (nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate), pa interes”. Në kontratë nuk ka parashikime mbi mënyrën e kalimit të shumës prej 75.000 eurosh tek huamarrësja apo qëllimin e marrjes së saj.

61.2 Në DIPP-në e vitit 2012, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, deklarohet: “Detyrim huaje ndaj z. F. Sh., 75.000 euro, në bazë të kontratës nr. {***}, dt. 18.09.2012, notere M. Ll., për të cilën nuk është shlyer asnjë vlerë”, si dhe “Të drejta pasurore nga investimi, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit dt. 16.10.2012, vërtetuar para noterit me nr. {***}, dt. 16.10.2012”. Kjo hua është deklaruar edhe në DIPP-të e viteve 2013 - 2016 nga bashkëshortja e subjektit, me sqarimin se nuk është shlyer asnjë vlerë.

61.3 Gjatë hetimit administrativ, lidhur me marrëdhënien me shtetasin F. Sh., si dhe kohën dhe mënyrën e marrjes së huas prej 75.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁶⁸: *Me shtetasin F. Sh. (Sh.) kam lidhje miqësore familjare. Me këtë person jam njohur në vitin 2005,*

⁶⁶ 3 (tre) kontrata shitblerjeje për shitje pasurish nga shtetasi F. Sh., konkretisht: kontratë shitblerje nr. {**} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2011; kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.12.2011; kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 20.12.2011, të shoqëruara me vërtetime nga dokumentet hipotekore.

⁶⁷ Me këtë shtetas, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën premtim shitje të datës 13.07.2005, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 92 m² të trajtuar më lart.

⁶⁸ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

me rastin e lidhjes së kontratës së porosisë për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”. Pas këtij momenti me këtë person kam zhvilluar marrëdhënie shoqërore që vijon aktualisht. Deklaroj me përgjegjësi se nuk kam trajtuar asnjë kallëzim apo procedim penal lidhur me shtetasin F. Sh. (Sh.)⁶⁹, shoqërinë “{***}” ShPK, përfshirë dhe shtetasin A. Ç. [...] Me sa kujtoj shuma e mësipërme është marrë cash nga bashkëshortja ime në zyrën e z. F. Sh., të ndodhur në atë periudhë në rrugën “Panorama”, në ditën e lidhjes së kontratës së huas. Dhënia e shumës është pasqyruar në vetë përmbajtjen e kontratës së huas [...]. Për shkak të moskthimit të huas brenda afatit të caktuar në kontratë, bashkëshortja ime dhe huadhënësi F. Sh. kanë rënë dakord për shtyrjen e afatit të kthimit të huas. Mes tyre është lidhur kontrata me nr. 5621 rep., nr. 1405 kol., datë 28.4.2017, me të cilën është bërë thjesht ndryshimi i kontratës së mëparshme të huas, duke shtyrë afatin e kthimit deri në muajin shtator 2022. Shuma e marrë hua nga shtetasi F. Sh. është përdorur për investim në kuadër të marrëdhënies së bashkëpunimit të lidhur mes bashkëshortes sime dhe shtetasit Z. Z. [...].

61.4 I pyetur më tej në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje, subjekti ka deklaruar se⁷⁰: Konfirmoj para Komisionit, se nga bashkëshortja ime është shlyer huaja e mësipërme. Shlyerja e huas është bërë në datat dhe me burimet e parave të mëposhtme: (1) Pagesë me bankë dt.13.12.2019, shuma 1,200,000 lekë nga të ardhurat nga pagat. (2) Pagesë me bankë dt.28.07.2020, shuma 3,500,000 lekë. Nga kjo shumë, 1,500,000 lekë janë siguruar nga të ardhurat nga pagat dhe pjesa prej 2,000,000 lekësh është siguruar nga aktmarrëveshja nr. {***} rep., {***} kol., dt. 23.07.2020, “Për zgjidhje jashtëgjyqësisht dhe pranim të vlerës së dëmshpërblimit. (3) Pagesë me bankë, dt.28.07.2022, shuma 36,000 euro. Kjo shumë është siguruar nga kontrata e kredisë nr. {***} rep., {***} kol., dt. 26.07.2022. Shpjegoj se marrja e kredisë me kontratën nr. {***} rep., {***} kol., dt. 26.07.2022, ishte e vetmja mundësi për të shlyer huan e marrë nga bashkëshortja ime në vitin 2012. Siç kam deklaruar në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, kjo hua është marrë për të mundësuar një bashkëpunim me shoqërinë “{***}” ShPK. Ky bashkëpunim është vlerësuar si mundësi e nevojshme për të shlyer huan e marra në vitin 2009 nga vjehrra dhe z. A. B. Ndërtimi që do të kryhej nga “{***}” ShPK, do të përfundonte brenda vitit 2015, pra dy vite para përfundimit të afatit të huas së marrë nga F. Sh.. Kemi besuar se ndërtimi do të përfundonte brenda afatit po ashtu dhe shitja e njësive të ndërtuara. Një fakt i tillë do të kishte mundësuar tërheqjen e shumës së financuar dhe të përfitimit përkatës brenda vitit 2017 dhe rrjedhimisht edhe huaja do të ishte shlyer brenda afatit të përcaktuar. Për shkak se dështoi bashkëpunimi me shoqërinë “{***}” ShPK, ky fakt krijoi një pamundësi për kthimin e shumës së huas ndaj z. Sh. brenda vitit 2017, në të cilin përfundonte afati i shlyerjes. Për këtë arsye, me shumë dashamirësi nga huadhënësi, i cili si edhe në raste të tjera ka qenë shumë i gatshëm për të më ndihmuar, afati është shtyrë deri në vitin 2022. Kemi besuar gjithmonë që “{***}” ShPK dhe z. Z. Z. do të përmbushnin detyrimet e krijuara me marrëveshjen e bashkëpunimit të vitit 2012. Edhe pas pesë viteve, pra edhe në vitin 2022, z. Z. nuk ka respektuar detyrimet kontraktore për të kthyer vlerën e investimit dhe për të paguar përfitimet përkatëse. Gjendur në këto kushte, e vetmja mundësi për të kthyer pjesën e pashlyer të huas, kishte mbetur

⁶⁹ Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigje nr. {***}, dt. 17.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, sipas së cilës, ndër të tjera, vërtetohet se për periudhën 2002 -2022 nuk rezulton që prokurori Armand Gurakuqi të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me shtetasin F. Sh./Sh. etj.

⁷⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7.

marrja e një kredie. Për këto arsye i jemi drejtuar bankave të nivelit të dytë, ku banka Credins aprovoi kërkesën për akordimin e kredisë, sipas kontratës nr. {***} rep, {***} kol., dt. 26.07.2022⁷¹.

61.5 Në dëshminë e dhënë para Komisionit⁷², shtetasi F. Sh., ndër të tjera, ka deklaruar: [...] marrëdhënia me Armandin ka filluar në 2005 – 2006, kur erdhi për të blerë një apartament. Krijua një marrëdhënie shumë të mirë, shumë miqësore dhe mua më ka lënë mbresa një djalë me një korrektesë [...] Nga 2012, siç e kemi ne në biznes herë ka para, herë s'ka para, unë kisha ca lek të lira dhe erdhi më tha dua të fus disa lek në një biznes ndërtimi, më ndihmon dot? Po mo, i thash unë, kisha në atë moment. Po unë maksimumi mund ti shlyej tha më shpejt a mund t'i shlyej dhe që nesër, varet si do eci, po bëjmë një kontratë 5 vjeçare. Po mo, e bëjmë. Unë nuk mund t'i jap me interes, plus Armandin e dua shumë vetë unë si person. Në parantezë, nuk kam pasur asnjë lloj interesi personal unë tek prokuroria, tek gjykata, te Armandi. [...] Thjesht duke pas besim te Mandi, e ndihmova me këtë punë. Nuk arriti dot t'i shlyente dhe më tha a mund të bëjmë një tjetër shtesë. [...] S'kam tha për momentin dhe bëmë një shtesë, shtojcë kontrate. Erdhi nga 2020 a 2021, nuk e mbaj mend mirë, bëmë një kontratë. Pas ca kohësh erdhi më tha do të marr një kredi në bankë, vajti te Credins-i në mos gabofsha se tani dhe unë nuk ia di tamam ato. Bëri shlyerjen e...sipas kësteve, sipas atyre tonave plus minuse[...]. Dikur mbaroi ai ndërtimin, mori ky lekët e veta e m'i ktheu. [...] Nuk i ndezi ajo punë, ata u vonuan në ndërtim, prandaj u vonua dhe Armandi në këtë pjesë. Mezi mori lekët e veta që të m'i kthente mua [...]. Nga aktet në dosje, rezulton se pavarësisht përpjekjeve të Komisionit për të kontaktuar me shtetasin Z. Z., me qëllim për ta pyetur në cilësinë e dëshmitarit, njoftimi i adresuar është kthyer mbrapsht dhe komunikimi me këtë shtetas nuk u realizua.

61.6 Në përfundim të hetimit administrativ, në kundërshtim të barrës së provës⁷³, subjekti ka deklaruar: [...] nga gjithë procesi i rivlerësimit rezulton e provuar se huaja që bashkëshortja ime ka marrë nga z. F. Sh. është zyrtarizuar në formën e një kontrate noteriale, konkretisht kontratës Nr. {***}, datë 18.9.2012. Ekzistenca e kësaj kontrate është konfirmuar edhe nga

⁷¹ Me përgjigjet e pyetësorëve 1 dhe 7, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: i. kontratë kredie konsumatore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.07.2022, të lidhur mes Bankës Credins ShA dhe Armand Gurakuqi në cilësinë e kredimarrësit, me objekt marrjen e një kredie në shumën 4.800.000 lekë, me afat 15 vjet me qëllim "Kredi individuale me hipotekë (shlyerje detyrimi)"; ii. aktmarrëveshje "Për zgjidhje jashtëgjyqësisht dhe pranim të vlerës së dëmshpërblimit" nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2020, përmes të cilës Armand Gurakuqi është dëmshpërblyer me shumën 4.000.000 lekë nga Shoqëria e Sigurimeve {***} ShA, për një aksident të ndodhur në muajin gusht të vitit 2018; iii. tri mandate bankare të Credins Bank të datave 13.12.2019, me përshkrim: "lik. i pjesshëm kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol."; 27.08.2020, me përshkrim "kalim në funksion të kont. rep. {***}, kol. {***} dhe {***} rep., kol. {***}"; dhe 28.07.2022, me përshkrim: "kalim sipas kont. 18/09.2012 dhe shtyrje kont. 24.12.2019", për transferimin përkatësisht të shumave 1.200.000 lekë, 3.500.000 lekë dhe 36.000 euro, nga G. G. te shtetasi F. Sh.

⁷² Sipas procesverbalit për marrjen e deklarimeve të shtetasit F. Sh., të datës 17.03.2023.

⁷³ Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës: Duket se nuk ka logjikë ekonomike në marrjen e një huaje prej 75.000 eurosh, për të kryer një investim në të njëjtën vlerë, ndërkohë që nuk është i qartë shkaku i marrjes së tyre, pa interes, nga një person me biznes – për t'i investuar tek një tjetër biznes, për zhvillimin e një projekti ndërtues – e për rrjedhojë, kjo huamarrje duket një veprim fiktiv. Për më tepër, vërehet se kjo mënyrë investimi – duke përdorur mjete monetare të huazuara, në një masë shumë më të madhe sesa ato të disponuara nga vetë subjekti – është hasur në mënyrë të përsëritur, sikurse është evidentuar edhe në pasuritë e tjera të analizuara më lart, e për rrjedhojë, ngrihen dyshime mbi vërtetësinë e huamarrjes në fjalë.

Komisioni gjatë hetimit administrativ të kryer. Në këto kushte, provohet në mënyrë të padiskutueshme lidhja e kësaj kontrate noteriale. [...] Edhe dëshmia që z. F. Sh. ka dhënë para Komisionit, provon plotësisht vërtetësinë e dhënies së huas sipas kontratës së vitit 2012. [...] logjika ekonomike nuk është një element i domosdoshëm për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e një kontrate noteriale. Besueshmëria do të vihej në dyshim në situata të qarta që cenojnë formën apo përmbajtjen e saj. Të tilla do të ishin falsifikimi i firmave të palëve në kontratë apo mungesa e burimit të ligjshëm të parave që janë pjesë e kushteve të kontratës, mohimi nga palët i lidhjes së saj apo rrethana të tjera të ngjashme. Nëse kontrata është lidhur ligjërisht, është konfirmuar dhe konfirmohet nga palët, është nënshkruar nga subjektet pjesëmarrëse, është e lidhur duke përdorur mjete monetare të ligjshme, ajo ka besueshmëri të plotë dhe duhet të pranohet si tillë. [...].

61.7 Në parashtrimet e datës 25.09.2025, dhe në seancën dëgjimore të datës 27.10.2025, në fokus të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të marrëdhënies së huas, ka qenë marrëdhënia e fortë e miqësisë me shtetasin F. Sh., edhe për shkak të një rrethane të paraqitur për herë të parë në Kolegj, si mbështetja që subjekti i rivlerësimit i ka dhënë të afërmit të huadhënësit për të tejkaluar një periudhë të vështirë të jetës së tij. I pyetur gjatë seancës dëgjimore në Kolegj mbi mënyrën e marrjes së shumës prej 75.000 eurosh nga bashkëshortja, dhe rolin e tij në këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë i është dorëzuar bashkëshortes së tij në zyrën e z. Sh., në prani të tij dhe të z. Z. Z., dhe se mes tij dhe bashkëshortes ka pasur një konsultim dhe dakordësi paraprake. Subjekti ka shpjeguar që shuma prej 75.000 eurosh i është dorëzuar bashkëshortes në *cash*, pasi e tillë ishte mundësia e ofruar nga z. Sh., dhe ky fakt do të konfirmohej në kontratën e huas. I pyetur mbi përpjekjet e subjektit dhe bashkëshortes së tij për të marrë kredi në bankë në këtë shumë, dhe dokumentimin e tyre, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga ana e tyre kishte pasur një interesim paraprak pranë drejtorive respektive të bankave të ndryshme, por mungesa e një përgjigjeje pozitive ka sjellë edhe mungesën e një aplikimi për nisjen e kësaj procedure. Me pak fjalë, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar që interesimi për marrjen e kredisë ka qenë verbal dhe jo me kërkesë formale, për sa kohë që nuk është paraqitur një akt që të provojë këtë interesim.

62. Në analizë të të gjithë dinamikës së fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, fakti i deklarimit të marrëdhënies së huas në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike të pasurisë që prej vitit 2012, si detyrim në shumën e plotë prej 75.000 eurosh, ndaj shtetasit F. Sh., së bashku me dokumentimin shkresor të saj të këtij viti, nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e saj. Me fjalë të tjera, deklaratat periodike vjetore përbëjnë provë, por si çdo provë, në zbatim edhe të përcaktimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përveçse duhet të mbështeten në prova të besueshme, duhet të analizohen në pajtueshmëri me provat e tjera. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm, qoftë në procesin e zhvilluar në Komision apo edhe atë në Kolegj, arsyet e dhënies hua nga shtetasi F. Sh. të një huaje me vlerë të madhe prej 75.000 eurosh, dhe pa interes, në disfavor të qartë të këtij shtetasi dhe në mospërputhje me çdo logjikë ekonomike. Likuidimi i saj në vitet 2019, 2020 dhe 2022, përmes tri kësteve, pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit, u vlerësua nga trupi gjykues se është bërë me qëllim që të provohej ekzistenca reale e kësaj marrëdhënieje huaje të marrë në *cash*, por jo me qëllim përmbushjen e “detyrimeve të vonuara” që buronin nga kontrata e huas. Këto veprime të kryera

gjatë procesit të rivlerësimit, pothuaj 7-10 vite më vonë nga momenti i pretenduar për marrjen e huas, u konsideruan nga trupi gjykues në drejtim të mosbesueshmërisë për ekzistencën reale të kësaj marrëdhënieje. Pavarësisht se marrëdhënia me shtetasin F. Sh. duket se ka ekzistuar më herët, marrëdhënia e huas me këtë shtetas, e pretenduar me forcë, edhe për shkak të marrëdhënies së miqësisë mes tyre, vendoset nën dritën e mosbesimit edhe për arsye të rrethanës së re, të bërë me dije për herë të parë në Kolegj, lidhur me mbështetjen që subjekti i rivlerësimit i kishte dhënë të afërmit të huadhënësit në një periudhë të vështirë që ai po kalonte. Në konkluzion të kësaj analize, duke mbajtur parasysh edhe analizën e akteve të paraqitura nga subjekti me parashtrimet sipas paragrafit 18 të këtij vendimi, në lidhje me marrëdhënien e huas së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me z. F. Sh., për shumën 75.000 euro, ashtu siç ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues vlerëson se pasja e burimeve të ligjshme për shumën e dhënë hua nga huadhënësi, si element i vetëm, nuk e bën të besueshme vërtetësinë e kësaj marrëdhënieje, e cila dukshëm është krijuar në mungesë të një logjike ekonomike. Për rrjedhojë, u vlerësua se huaja nuk ka qenë burimi i vërtetë i shumës që është investuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të vitit 2012, të lidhur mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit Z. Z., ortak i shoqërisë “{***}” ShPK. Në këtë vlerësim trupi gjykues mbajti në konsideratë ndër të tjera:

i. Transaksionet në *cash* midis bashkëshortes dhe subjektit të rivlerësimit dhe huadhënësit të pretenduar, z. F. Sh., si dhe për dorëzimin tek z. Z. Z., në një vlerë të lartë, prej 75.000 eurosh.

ii. Marrjen e një huaje nga një individ që është pronar i një shoqërie me objekt veprimtarie punime ndërtimi, për zhvillimin e një projekti ndërtues tek një shoqëri tjetër ndërtimi, duke mos investuar asnjë shumë nga të ardhurat apo kursimet e vetë subjektit dhe bashkëshortes së tij.

iii. Marrjen hua të një shume të konsiderueshme pa interes për një afat të gjatë⁷⁴, me qëllim investimi dhe përfitimi të ardhurash vetëm nga bashkëshortja/subjekti i rivlerësimit, në mungesë të një logjike ekonomike për përdorimin e mjeteve financiare dhe mungesën e fitimit prej tyre për një periudhë shtatë deri dhjetë [7-10]-vjeçare nga ana e huadhënësit.

iv. Përdorimin në krijimin e pasurive, nga subjekti i rivlerësimit të mjeteve monetare të personave të tretë, në një masë më të madhe sesa ato të disponuara dhe të mundshme për t'i krijuar vetë, madje edhe për t'i shlyer ato me burimet e veta financiare.

63. Trupi gjykues, mori në analizë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit mes bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK, me ortak z. Z. Z. Në këtë drejtim, nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues vëren se, Komisioni, në funksion të konkluzionit të tij për cenimin e besimit të publikut, ka parashtruar një sërë argumentesh apo rrethanash mbi mungesën e besueshmërisë së deklarimeve të subjektit, se nga investimi i bashkëshortes nuk janë realizuar përfitime, të tilla si: (i) Investimi i kryer në shoqërinë “{***}” ShPK, mbart tiparet që konkretizohen në ortakëri – ekspozim ndaj risqeve të biznesit në këmbim të një përfitimi në raport me përfitimet e shoqërisë. (ii) Hipotekimi i apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit për të siguruar kredinë e marrë nga znj. Ç. dhe z. V. në shumën 5.000.000 lekë, për apartamentin e porositur tek shoqëria “{***}” ShPK në komunën Dajt, në të cilën bashkëshortja e tij kishte investuar. (iii) Z. F. Sh., në dëshminë e

⁷⁴ E shtyrë/zgjatur edhe për 5 vite të tjera, me të njëjtat kushte, dhe e shlyer vetëm gjatë procesit të rivlerësimit.

tij, ka pohuar të kundërtën e asaj që deklarohet mbi mospërfitimin e asnjë shume nga ky investim; (iv) Mungesa e një akti zyrtar që të revokonte apo ndryshonte marrëveshjen e bashkëpunimit, do të thotë që kjo e fundit është ende në fuqi, dhe prodhimi i efekteve të pritshme, sipas saj (përfitimi i 15% të fitimit që shoqëria do të realizojë nga ky investim), mund të ketë pasur shtyrje në kohë, por në fund e sipër detyrimi që mbart shoqëria ndaj familjes së subjektit mbetet gjithmonë i ekzekutueshëm (pavarësisht problematikave personale të ortakëve apo administratorëve të përkohshëm). (v) Nga vetë subjekti apo bashkëshortja nuk është kryer asnjë përpjekje ndër vite për anulimin apo revokimin e saj, dhe as ndonjë veprim për përfitimin e të drejtave të dakordësuara apo për riparimin e dëmeve të pretenduara nga mospërmbushja e detyrimeve nga ana e shoqërisë.

64. Në drejtim të sa më lart, trupi gjykues, veç sa parashtruar në paragrafët më sipër, nga analizimi i akteve në fashikullin e hetimit administrativ, konstaton se:

64.1 Në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 16.10.2012, të lidhur në zyrën e shoqërisë “{***}” ShPK, në Tiranë, mes palës së parë Z. Z. (Kacani), ortak pranë shoqërisë investitore “{***}” ShPK, dhe palës së dytë G. G., në nenin 1, të titulluar “Kushtet parakontraktore” përcaktohet se: *Shoqëria “{***}” ShPK, me anë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt.07.09.2011, të hartuar para noteres G. Sh., të lidhur mes saj dhe pronarëve të truallit N. L., U. V., R. M., E. V., ka marrë përsipër detyrimin e ndërtimit të një kompleksi banimi mbi trojet e këtyre të fundit, përkundrejt kalimit në pronësinë e tyre të 33% të ndërtimit të ardhshëm. Për këto ndërtime Komuna Dajt ka miratuar lejet e ndërtimit: (1) nr. {***} prot., dt. 21.08.2012, të miratuar me vendimin nr. {***} të KRRT-së nr. {***}, dt. 27.09.2011, të Komunës Dajt; (2) nr. {***} prot., dt. 21.08.2012, të miratuar me vendimin nr. {***} të KRRT-së nr. {***}, dt. 27.09.2011, të Komunës Dajt. [...]. Në nenin 3, të titulluar: “Raportet e pjesëmarrjes” përcaktohet se: Përmes kësaj marrëveshjeje, dy palët bien dakord që pala e dytë, shtetasja G. G., të kontribuojë financiarisht në investimin e ndërtimit të dy objekteve në shumën 75.000 euro, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre. Palët bien dakord që shtetasja G. G., nga vlera e pjesëmarrjes në investim... Z. Z. (K.) në shoqërinë “{***}”, të marrë pjesë në investimin në vlerë të dy objekteve, deri në vlerën maksimale 15% të gjithë preventivit të vlerës së ndërtimit. Në këmbim, shtetasja G. G. do të përfitojë 15% të vlerës së fitimit që do të sigurohet nga shitja e objektit dhe kthimin e shumës së parapaguar si vlerë investimi”. Në vijim, në nenin 4 të titulluar “Forma e pjesëmarrjes” përcaktohet se: “1. Pala e dytë investitore G. G., brenda totalit prej 15% pjesëmarrje në investim, ka të drejtën e investimit në mjete monetare. Në vlerësimin e pjesës prej 15% të investimit prej shtetasjes G. G., do të merren në konsideratë edhe shumat që do të sigurohen nga shitjet e sipërfaqeve të objekteve që do të përdoren për investim. 2. Pala e dytë investitore paguan në mënyrë periodike sipas vlerës së situacioneve adresuar nga shoqëria sipërmarrëse për investitorin Z. Z.”. Në nenin 7, të titulluar “Marrja në dorëzim” përcaktohet se: “Pala e dytë investitore do të marrë tërësisht 15% të vlerës së fitimit nga shitja e pjesë ve takuese të investitorit Z. Z., shtuar dhe vlerën e investuar në momentin e përfundimit të shitjeve. Për këtë, palët do të hartojnë një akt shkresor ku do të pasqyrohet likuidimi i detyrimeve mes palëve”.*

64.2 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi përfitimet financiare të realizuara nga marrëveshja e investimit, si dhe fazën e ndërtimit, shitjes dhe regjistrimit të objekteve të

ndërtuara nga shoqëria “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁷⁵: *Lidhur me marrëveshjen e mësipërme të bashkëpunimit, nuk është realizuar asnjë përfitim financiar pavarësisht kërkimeve të realizuara tek z. Z. Mospagimi, jo vetëm i përfitimit financiar sipas marrëveshjes së mësipërme, por edhe i vetë shumës që i është dorëzuar z. Z. si financim, ka krijuar shumë vështirësi dhe pengesa në shlyerjen e detyrimeve monetare që ne kemi pasur si familje. Ky fakt ka ndikuar në vonesat për shlyerjen e huave të marra nga shtetasit H. H., A. B. dhe F. Sh., duke na detyruar që të marrim kredi bankare pranë Bankës Credins. [...] Me gjithë përpjekjet e kryera, prej një periudhe të gjatë kohore, ka qenë e pamundur të kontaktojmë me shtetasin Z. Z.. Këtij personi i kemi kërkuar vazhdimisht që të kthejë shumën e investimit dhe të përmbushë detyrimet kontraktore për të paguar përfitimin përkatës financiar, por pas interesimeve tona të shumta ai ka ndërprerë çdo komunikim. Për këto arsye, unë nuk disponoj asnjë informacion lidhur me fazën e ndërtimit, regjistrimit apo shitjes së objektit. [...] Deri në këtë moment, nga qëndrimet e z. Z. na janë shkaktuar dëme të rënda ekonomike dhe na janë krijuar situata të rënda familjare ku vlen të theksohet pamundësia për shlyerjen e huave të marra. Ajo marrëdhënie u krijua me qëllim për të mundësuar krijimin e disa të ardhurave ekonomike të nevojshme për familjen për të kryer shlyerjen e huave të marra por ka rezultuar në një dështim tërësor që na ka ngarkuar familjarisht me një barrë të rëndë ekonomike dhe njerëzore”.*

64.3 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dhënë shpjegime lidhur me faktin e bllokimit⁷⁶ në favor të BKT-së të apartamentit me sipërfaqe 61 m², në rrugën “{***}”, Tiranë (trajtuar më lart në këtë vendim), sipas kontratë hipoteke me nr. {***} rep., {***} kol., datë 17.06.2015, për kredinë bankare të marrë nga shtetasit E. Ç. dhe A. V., sipas kontratës së kredisë nr. {***}, datë 17.06.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁷⁷: *“Apartamenti i mësipërm është hipotekuar për të siguruar kredinë e marrë nga znj. E. Ç. dhe z. A. V., pasi këta persona kanë porositur, më anë të kontratës përkatëse të porosisë, një apartament të ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në Komunën Dajt. Mes përfaqësuesit të shoqërisë, shtetasit Z. Z. dhe bashkëshortes sime, G. G., është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi, e vërtetuar para noterit me vërtetimin e nënshkrimit nr. {***} rep. dhe {***} kol., dt.16.10.2012, me të cilën është rënë dakord për investimin nga bashkëshortja në ndërtimin e mësipërm, në shumën 75.000 euro. Në këto kushte, shitja e apartamenteve të ndërtuara nga “{***}” ShPK ishte e lidhur drejtpërdrejt me sigurimin e përfitimeve që do të rridhnin nga kontrata e bashkëpunimit të datës 16.10.2012. Nisur nga fakti se shtetasit E. Ç. dhe A. V. nuk posedonin një pasuri tjetër për të vendosur në hipotekë, për të mundësuar marrjen e kredisë, nga z. Z. na është kërkuar vendosja në hipotekë e një pasurie në pronësinë tonë. Për shkak se shitja e apartamentit nga “{***}” ShPK konvenionte me të drejtat që rridhnin nga marrëveshja e bashkëpunimit e datës 16.10.2012, unë dhe bashkëshortja ime kemi rënë dakord që të vendosnim në hipotekë apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”. Vendosja e pasurisë në hipotekë u realizua edhe për shkak se bllokimi i pasurisë do të ishte i përkohshëm, deri në momentin e regjistrimit të apartamentit të porositur nga znj. E. Ç. dhe z. A. V. në ZVRPP dhe në këtë moment do të bëhej zëvendësimi i hipotekës së banesës sonë në rrugën “{***}”, me apartamentin që do të blihej nga shtetasit Ç.*

⁷⁵ Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 7.

⁷⁶ Shih shkresë e ZQRPP-së, Tiranë, nr. {***} prot., datë 12.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së dhe shkresë e BKT-së, drejtuar Komisionit, me nr. {***} prot., datë 10.03.2023.

⁷⁷ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

dhe V.. [...] Nga vera e vitit 2020 e në vijim, kam pasur disa komunikime dhe biseda me shtetasen E. Ç., por pavarësisht predispozicionit për të më ndihmuar për heqjen e banesës nga hipoteka, ajo nuk ka mundësuar gjetjen e një prone tjetër për ta vendosur në hipotekë pranë bankës. Kjo, pasi edhe apartamenti i porositur nga ana e saj pranë shoqërisë “{***}” ShPK nuk është regjistruar në emër të znj. Ç. dhe z. V., pasi për shkak të problemeve të krijuara mes ortakëve të shoqërisë, nuk është lidhur kontrata përkatëse e shitblerjes së apartamentit, e për pasojë as regjistrimi i kësaj prone pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (AShK). Në këto kushte, kam qenë i detyruar që për çlirimin nga hipoteka të banesës së ndodhur në rrugën “{***}”, të vendosja në hipotekë, për të garantuar kredinë e znj. E. Ç. dhe z. A. V., banesën në bashkëpronësinë time dhe të bashkëshortes, pra apartamentin ku jetonim, të ndodhur në rrugën “{***}”.

64.4 Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga noterja G. Sh.⁷⁸, evidentohen mes të tjerash aktet: (i) Kontratë investimi dhe sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.09.2011, të lidhur mes pronarëve të truallit N. L., U. V., R. M. dhe E. L., investitorëve Z. Z. (K.) dhe A. Dh., dhe shoqërisë “{***}” ShPK, të cilët bien dakord që pas marrjes së lejes së ndërtimit, të investojnë në truallin në bashkëpronësi të pronarëve të mësipërm, ndodhur në {***}, Tiranë, për ndërtimin e një kompleksi banimi me godina 4 kate + papafingo + kat nëntokësor parkim, 30% e të cilit do të kalojë në pronësinë e palës pronare. (ii) Shtesë e kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2013, e lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori Z. Z., dhe pronarit të truallit R. M., me objekt përcaktimin në natyrë të sipërfaqes ndërtimore që do të kalojë në pronësi të tij. Në këtë kontratë përcaktohet se objektet janë ndërtuar me një sipërfaqe sheshi ndërtimi prej 6.800 m², nga e cila pronarit R. M. i takon 367 m², të ndara në apartamente banimi, duke përcaktuar apartamentet konkrete që i takojnë këtij bashkëpronari. (iii) Shtesë e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.09.2013, e lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori Z. Z., dhe pronarit të truallit E. L., në të cilën përcaktohet se këtij bashkëpronari do ti takojë sipërfaqja prej 431.3 m² të ndara në disa apartamente. (iv) Kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2014, e lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori Z. Z., z. A.s S., në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “{***}” ShA, në cilësinë e furnizuesit, me objekt ndërtimin dhe shitjen në të ardhmen të një apartamenti në objektin nr. {***} të rezidencës “{***}”, që po ndërtohet nga shoqëria “{***}” ShPK në bazë të vendimit nr. {***}, datë 27.09.2011 të KRrT-së së Komunës Dajt, me sipërfaqe 66.5 m², në vlerën 33.025 euro, e cila do të paguhet me dy këste. (v) Kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.03.2014, të lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK përfaqësuar nga Z. Z. dhe shtetasit E. V., me objekt porositjen e një apartamenti në objektin nr. {***} të rezidencës {***} që po ndërtohet nga shoqëria “{***}” ShPK, me sipërfaqe 95.9 m², me çmim 47.950 euro, nga i cili kësti i parë në masën 14.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë në masën 17.000 euro do të paguhet brenda datës 31.08.2014, dhe kësti i 3-të, në masën 15.000 euro, brenda datës 31.12.2014, me marrjen në dorëzim të apartamentit, kurse kësti i katërt, në masën 1.950 euro, me marrjen e certifikatës së pronësisë.

⁷⁸ Me shkresën e datës 22.02.2023, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 23.02.2023.

64.5 Në përfundim të hetimit administrativ, në kundërshtim të rezultateve të hetimit,⁷⁹ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Nga tërësia e hetimeve të Komisionit nuk ka rezultuar asnjë pagesë nga “{***}” ShPK apo z. Z. në favor të bashkëshortes sime. Nëse do të ishin siguruar përfitime nga investimi, ato do të ishin tërësisht të ligjshme, dhe për pasojë do të ishin deklaruar para Komisionit apo ILDKPKI-së. Madje këto përfitime do të ishin përdorur për shlyerjen e huave të marra në vite dhe do të kishin shmangur marrjen e kredisë pranë bankës Credins për shlyerjen e huas ndaj z. Sh.. Për këto arsye vlerësohet se nuk është i mbështetur dyshimi për vërtetësinë e deklarimeve mbi mosmarrjen e përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit.*

65. Në parashtrimet e datës 25.09.2025, të paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mosrealizimi i përfitimeve nga marrëveshja e bashkëpunimit/investimit të vitit 2012 ka ardhur si pasojë e pamundësisë financiare të shtetasit Z. Z., për shkak të detyrimeve të shumta financiare që ky shtetas kishte ndaj të tretëve, si dhe për shkak të arrestimit të tij që në vitin 2021. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar gjithashtu se nga marrëveshja e bashkëpunimit të vitit 2012 mes bashkëshortes së tij dhe shtetasit Z. Z., vlera e pritshme e përfitimit të bashkëshortes do të ishte 15% e vlerës së fitimit që do t’i përkiste investitorit Z. Z., që i takon shuma 44.327 euro, dhe jo 15% e fitimit total të investimit siç pretendohet nga Komisioni. Në seancën dëgjimore të datës 27.10.2025 të zhvilluar në Kolegj, i pyetur mbi mënyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të termave të marrëveshjes nga ana e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *për shkak të marrëdhënieve miqësore që kishim me familjen e z. Z., vetëm në këto takime zhvillohej një bisedë që çfarë mund të na thoshte në vija të përgjithshme. Pra, bashkëshortja ime nuk ka pasur tagra që të shkonte dhe të pyeste tek kompania, e vetmja mundësi ishte që të pyesnim tek Z.. Fakti ishte që ne, në momentin që bënim vizita për të kaluar në Rrugën e Dajtit, aty ku ndodhet edhe objekti, ne shikonim që ndërtimi vazhdohej dhe unë bashkë me bashkëshorten herë pas here, bashkëshortja i ka bërë dhe foto, thjesht për të konfirmuar që po ndërtimi po ecën. Pra, kjo ishte mënyra se si ne po shikonim që investimi për të cilin kishte marrë përsipër z. Z., ishte duke u zhvilluar.[...]. Ndërkohë që unë dhe bashkëshortja ime kemi zhvilluar komunikime të vazhdueshme me Z., qoftë edhe nëpërmjet aplikacioneve të ndryshme, me qëllim për të konfirmuar çfarë po bëhet me këtë kontratë, sepse situata ekonomike e familjes time ishte rënduar. Në vijim, i pyetur mbi metodologjinë e përllogaritjes së detyrimit në formë huaje të shtetasit Z. Z. ndaj bashkëshortes së subjektit, në vlerën 130.000 euro, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: [...] {***} do të investonte 75% të ndërtimit. Normalisht do të merrte mbrapsht 75% të fitimit, por përpara se {***} do të merrte 75%, fillimisht do të merrnin pronarët e tokës 33% që janë në kushtet parakontraktore. Pra, 33% e ndërtimit i kalonte pronarëve të tokës, ndërkohë 25% ishin investitorë të tjerë. Pra, 33 dhe 25 i thonë 58% e merrnin palët e tjera. Nga pjesa që ngelte, pra 42%, {***} pra merrte 42% si kompani {***}. Tani edhe në këtë pjesë 42%, Z. nuk merrte 42% se ishte 50% ortak dhe duke qenë 50% ortak ai merrte 21% të fitimit nëse do të sigurohej, nëse do të rezultonte me fitim. Pra, 21% i përkisnin si individ vetë Z. dhe nga kjo pjesa 21%, bashkëshortja ime do të merrte 15%, pra do të merrte 2.5% të fitimit të Z., pra 15% më fal të fitimit të Z. dhe unë në parashtrimet e mia kam bërë dhe analizën sesa është kjo vlerë. Si do të përkthehet kjo vlerë*

⁷⁹ Komisioni ka arritur në konkluzionin paraprak se: Subjekti ka hipotekuar apartamentin në pronësi të tij, për të siguruar kredinë e marrë nga znj. Ç. dhe z. V., në shumën 5.000.000 lekë, për apartamentin e porositur tek shoqëria “{***}” ShPK, në komunën Dajt, në të cilin bashkëshortja e tij kishte investuar, çka ngre dyshime mbi deklaratimet e tij mbi ecurinë e investimit të kryer dhe për mospërfitimin e asnjë shume nga ky investim.

konkretisht në vlerë financiare? 44.000 euro, kaq do të përfitonte bashkëshortja ime nga gjithë kjo marrëdhënie do të merrte mbrapsht shumë që kishte marrë hua dhe do t'ia shlyenim F. [...].

66. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të parashtruara më lart, si dhe duke mbajtur parasysh analizën e akteve të paraqitura nga subjekti me parashtrimet në Kolegj, si në paragrafin 18 të këtij vendimi, *lidhur me investimin e kryer prej bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2012 të nënshkruar mes saj dhe shtetasit Z. Z., në cilësinë e ortakut të shoqërisë investitore “{***}” ShPK*, trupi gjykues vlerësoi aktet e administruara në fashikull dhe krijoi bindjen se bashkëshortja dhe subjekti kanë realizuar përfitime nga kjo marrëveshje bazuar në argumentet/faktet [dhe jo vetëm], që parashtrohen në vijim:

i. Marrëveshja e bashkëpunimit ka parashikuar investimin dhe fitimin në përqindje të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në këmbim të investimit të vlerës fillestare prej 75.000 eurosh. Konkretisht, në nenin 3 përcaktohet se bashkëshortja e subjektit [...] *nga vlera e pjesëmarrjes në investim e Z. Z. (K.) në shoqërinë {***}, të marrë pjesë në investimin në vlerë të dy objekteve, deri në vlerën maksimale 15% të gjithë preventivit të vlerës së ndërtimit. Në këmbim, shtetasja G. G. do të përfitojë 15% të vlerës së fitimit që do të sigurohet nga shitja e objektit dhe kthimin e shumës së parapaguar si vlerë investimi.* Në vijim, në nenin 4 përcaktohet se: *Pala e dytë investitore G. G., brenda totalit prej 15% pjesëmarrje në investim, ka të drejtën e investimit. Në vlerësimin e pjesës prej 15% të investimit të shtetasës G. G., do të merren në konsideratë edhe shumat që do të sigurohen nga shitjet e sipërfaqeve të objekteve që do të përdoren për investim.* Trupi gjykues, bazuar në përcaktimet e sipërcituara lidhur me formulën e dakordësuar për investim, vlerësoi se investimi i subjektit të rivlerësimit në bazë të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi ka qenë në vlerën që rezulton nga investimi fillestar, në shumë prej 75.000 eurosh, e shtuar me përqindjen e fituar nga shitja e sipërfaqeve të objekteve. Ky qëndrim i trupit gjykues mbështetet edhe në parashikimet e nenit 4, pika 2, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ku përcaktohet forma e pjesëmarrjes në investim, sipas të cilit bashkëshortja e subjektit do të kryente pagesa për investimin në mënyrë periodike sipas situacioneve adresuar nga shoqëria sipërmarrëse për investitorin Z. Z.. Në këto kushte, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në deklaratat e interesave periodike private dhe në deklaratën *vetting*, vlerën e shtuar të investimit që rezultonte periodikisht, si pjesë takuese nga shitja e sipërfaqeve të objekteve, e cila përfshihej në vlerën maksimale të investimit prej 15% të gjithë preventivit të vlerës së ndërtimit.

ii. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dy lejeve të ndërtimit me nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., të datës 21.08.2012 në bazë të vendimit nr. {***}, datë 27.09.2011, të KRRt-së së Komunës Dajt, ndërtimet objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2012 kanë përfunduar më së shumti brenda vitit 2015.

iii. Lidhja në datën 12.09.2013 e kontratave të sipërmarrjes me të paktën dy prej pronarëve të truallit ku po kryhej investimi, për ndarjen e pjesëve takuese të tyre, në njësitë dhe sipërfaqet konkrete në objektet e ndërtuara, provojnë se ndërtimi ka qenë më së paku në një fazë të avancuar e drejt përfundimit të tij. Përveç sa më sipër, nga aktet e administruara në fashikull,

provohet se ka pasur kontrata porosie⁸⁰ për apartamente të ndodhura në rezidencën “{***}” të ndërtuara nga shoqëria “{***}” ShPK, në bazë të vendimit nr. {***}, datë 27.09.2011, të KRRt-së së Komunës Dajt, si dhe përfitim të vlerave monetare nga kjo shoqëri në vitin 2014.

iv. Në qershor të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur hipotekë mbi apartamentin e tij të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në favor të Bankës Kombëtare Tregtare ShA, me qëllim sigurimin e kredisë së marrë pranë kësaj banke nga shtetasit E. Ç. dhe A. V. , të cilët kishin lidhur kontratë porosie për apartament në ndërtimin që po kryhej nga “{***}” ShPK.

v. Mungesa e ndërmarrjes së ndonjë veprimi procedural apo ligjor nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në eventualitetin, siç pretendohet, se duhej siguruar zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për të mbrojtur interesat dhe garantuar përfitimet për të cilat kishin hyrë në këtë marrëveshje bashkëpunimi, provon se nuk ka pasur problematika në zbatimin e saj.

vi. Aktet e referuara⁸¹ nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, por edhe gjatë seancës gjyqësore në Kolegj, në mbështetje të pretendimeve të tij për pamundësinë e marrjes së përfitimit nga marrëveshja e bashkëpunimit, të konsultuara nga trupi gjykues nga burime të hapura, si faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit, përveçse datojnë për veprime përmbarimore të ndërmarrja të paktën prej muajit mars 2020⁸², ato nuk provojnë që problemet financiare të cilat kanë passjellë nevojën për marrjen e tyre, të kenë qenë të lidhura me projektin e investimit/ndërtimin e objekteve për të cilat ishte dakordësuar marrëveshja e bashkëpunimit.

vii. Metodologjia e përlllogaritjes së fitimit nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, si dhe vlera e pretenduar në shumën 55 mijë euro⁸³, e shpjeguar në parashtrime dhe gjatë seancës gjyqësore në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, u vlerësuan nga trupi gjykues si të pabesueshme pasi ato nuk janë në përputhje me përcaktimet e saj sa i përket pjesëmarrjes në investim, si dhe duket se është bazuar në të dhëna hipotetike⁸⁴ e jofaktike, të pa lidhura me: (i) vlerën totale të preventivit për vlerën e ndërtimit; (ii) vlerën e pjesëmarrjes në investim të z. Z. Z.; (iii) sipërfaqet e ndërtimit të porositura/shitura; (iv) çmimet e shitjes së sipërfaqes së ndërtimit sipas kontratave të nënshkruara me porositësit/blerësit, si dhe nuk mban në konsideratë analizën që duhet kryer e shpenzimet/detyrimet që duhet të zbriten për llogaritjen e fitimit të realizuar.

67. Trupi gjykues analizoï shkaku e ankimit edhe në drejtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se: (i) *prishmëritë e Komisionit, që bashkëshortja e tij duhej që në vitin 2012 të*

⁸⁰ Referuar dokumentacionit të përcjellë nga notere G. Sh., me shkresën e datës 22.02.2023, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 23.02.2023.

⁸¹ Urdhura sekuestro konservative të aksioneve, kuotave dhe aktiveve të shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. Z. Z.

⁸² Të paktën rreth 8 vite pas nga lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit, dhe 5 vite nga përfundimi i afatit të lejeve të ndërtimit.

⁸³ Kjo shumë, së bashku me shumën prej 75 mijë eurosh, të investimit fillestar i është njohur si detyrim subjektit të rivlerësimit nga z. Z. Z. në deklaratën noteriale të vitit 2021.

⁸⁴ Subjekti i rivlerësimit, në përlllogaritjen e fitimit që pritej të realizohej nga bashkëshortja në përfundim të investimit, sipas parashtrimeve të paraqitura, për përcaktimin e çmimit të shitjes së apartamenteve, i është referuar të dhënave të tregut të lirë të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB), duke përcaktuar një çmim prej 550 euro/m². Ndërsa, çmimin e posteve të parkimit të mbyllura e ka përlllogaritur në masën 70% të çmimit të shitjes së apartamenteve për m², përkatësisht në vlerën 385 euro/m². Në këtë përlllogaritje, subjekti i rivlerësimit nuk përcakton vitet e referencës në EKB, pavarësisht ekzistencës së kontratave të porosisë për apartamentet e ndodhura në rezidencën “{***}”, të ndërtuara nga shoqëria “{***}” ShPK.

kishte paraparë të ardhmen që shtetasit F. Sh. dhe Z. Z. do të kishin çështje penale në vijim, është në kundërshtim me limitet e funksionimit të qenies njerëzore e për pasojë kurrsesi nuk duhet të lejohet të shërbejë si bazë për marrjen e masës ekstreme disiplinore ndaj një magjistrati; (ii) sa i takon ekzistencës së çështjeve penale ndaj shtetasit F. Sh., kjo e dhënë është paraqitur në mënyrë të rreme në vendimin objekt ankimi, pasi dhe vetë Komisioni ka konfirmuar se ky person është pyetur vetëm në cilësinë e deklaruesit; (iii) Komisioni ka paraqitur në mënyrë të cunguar në vendim të dhënat në lidhje me shtetasin Z. Z., të cilat janë regjistruar në vitin 2021, pra pothuaj pas 10 vitesh, sikurse pasqyrohet në rezultatet e hetimit; (iv) Komisioni nuk ka përfshirë në vendim elemente të rëndësishme lidhur me shtetasin Z. Z., lidhur me dënimin e tij për veprën penale “Mashtrimi” parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, pasi një mungesë e tillë përgjegjshmërie ligjore është shfaqur nga shtetasi Z. Z. edhe në dëm të bashkëshortes së tij.

68. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues vëren se Komisioni, në funksion të konkluzionit të tij mbi cenimin e besimit të publikut, ka arsyetuar ndër të tjera se⁸⁵: [...] e vlerësuar edhe në tërësinë e saj, fakti se shtetasit F. Sh. (huadhënësi) dhe Z. Z. (investitori) kanë pasur hetime dhe procese penale në Prokurorinë ku vetë subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit, ngre dyshime të arsyeshme se vetë kjo marrëdhënie nuk duhej të vendosej qysh prej fillimit.

69. Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të Komisionit konstatohet se:

69.1 Në lidhje me shtetasin F. Sh., nga dokumentacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë⁸⁶, rezulton se mbi bazën e kallëzimit të shtetasve L. B. dhe E. I. është regjistruar nga prokurori S. H. procedimi penal nr. {***/2013, për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, pa emër personi që i atribuohet vepra penale, procedim i cili është pushuar me vendimin e datës 23.04.2014, të po këtij prokurori. Emri i shtetasit F. Sh., dhe ai i subjektit “{***}” ShPK përmenden edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***} akti, datë 30.01.2020, përmes të cilit është vendosur pranimi i kërkesës së prokurores M. M. për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 16.04.2019, regjistruar për veprën penale “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, të referuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në lidhje me subjektin “{***}” ShPK. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dhënë shpjegime mbi çështje penale të këtij shtetasi në Prokurorinë e Tiranës, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se⁸⁷ [...] z. Sh. ka qenë i kallëzuar në kuadër të procedimit penal nr. {***/2013. Nga aktet bashkëlidhur, rezulton se çështja penale nuk ka qenë në ngarkim të tij pasi z. Sh. nuk ka qenë person nën hetim dhe as i pandehur por thjesht person që ka dijeni për rrethanat e hetimit. [...].

69.2 Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së

⁸⁵ Shih paragrafin 145 të vendimit të Komisionit.

⁸⁶ Me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., dt. 07.03.2023.

⁸⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 7.

Shkallës së Parë Tiranë⁸⁸, në lidhje me shtetasin Z. Z., rezultojnë të dhënat si vijojnë: (i) Me vendimin e datës 31.05.2022, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prokurorja M. M., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal të shtetasit Xh. T., i cili ka pretenduar se është mashtruar nga shtetasi Z. Z.. (ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 21.07.2022, ka deklaruar fajtor shtetasin Z. Z. për kryerjen e veprës penale “Kallëzimi i rremë”. (iii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 04.05.2022, ka deklaruar fajtor këtë shtetas për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. (iv) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 30.06.2021 të prokurorit S. H., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e shtetasit A. H. ndaj shtetasit Z. Z. për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës”. (v) Me vendimin e datës 30.06.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 30.06.2021, të prokurorit G. Sh., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e bërë nga Zyra e Përmbarrimit Privat “{***}” ndaj shtetasve Z. dhe O. Z. për veprën penale “Kallëzimi i rremë”. (vi) Me vendimin e datës 10.07.2011, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prokurorja S. S. ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin e shtetasit A. G. për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” ndaj shtetasit Z. K.. (vii) Me kërkesën e datës 08.10.2020, prokurori P. H. i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë gjykimin e çështjes në ngarkim të pandehurit Z. Z. për veprën penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i KP. (viii) Me vendimin e datës 26.03.2020, prokurorja I. A. ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {***}, dt. 11.03.2020 të shtetasit B. M. ndaj shtetasit Z. Z. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për veprën penale të “Mashtrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Gjithashtu evidentohen edhe disa kallëzime penale të vitit 2021, të vetë shtetasit Z. Z., për të cilat Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

70. Bazuar në sa më lart, në lidhje me shtetasin F. Sh. nuk evidentohen të dhëna për çështje penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi, ndërkohë për shtetasin Z. Z. rezultojnë të dhëna për çështje penale të regjistruara në ngarkim të tij dhe vendime gjykate për dënimin e tij, të cilat i përkasin viteve 2020 dhe 2022. Për të dy këta shtetas nuk rezultojnë materiale kallëzuese të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit. Në të tilla kushte, trupi gjykues e gjen jo të mbështetur vlerësimin e Komisionit për ta renditur këtë rrethanë, që në vlerësimin tërësor ka çuar drejt konkluzionit për cenimin e besimit të publikut. Sa i takon pretendimit të subjektit se të dhënat lidhur me shtetasit F. Sh. dhe Z. Z. janë paraqitur në mënyrë të rreme në vendimin e Komisionit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni mund t’i kishte parashtruar në mënyrë më të plotë këto fakte penale duke saktësuar nëse procedimet penale ishin ose jo të regjistruara në ngarkim të shtetasit F. Sh., dhe kohën në të cilën datonin çështjet penale të dërguara për gjykim apo dënimet e shtetasit Z. Z.. Sa i takon argumentit tjetër të subjektit të rivlerësimit në ankim se *Komisioni nuk ka përfshirë në vendim elemente të rëndësishme lidhur me shtetasin Z. Z., lidhur me dënimin e tij për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, pasi një mungesë e tillë përgjegjshmërie ligjore është shfaqur nga shtetasi Z. Z. edhe në dëm të*

⁸⁸ Me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., dt. 07.03.2023, shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 14.10.2022, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 05.01.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

bashkëshortes së tij, duke tashmë si një argument i rrëzuar nga vetë subjekti në parashtrime me paraqitjen e deklaratës noteriale të vitit 2021 të këtij shtetasi për njohjen e detyrimit ndaj bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

71. Veç sa është arsyetuar e konkluduar më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, mekanizmi i zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit⁸⁹, për të siguruar përfitime përmes një investimi në vlerën 75.000 euro, në rrethana të tilla si: (i) duke përdorur si burim totalisht mjete financiare të huazuara, veprim ky i përsëritur në krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit; (ii) në mungesë totale garancish apo mekanizmash mbikëqyrës të ecurisë apo suksesit të investimit; (iii) me kryerje transaksionesh në vlera të konsiderueshme jashtë sistemit bankar; (iv) në mungesë transparence ndaj institucioneve kontrolluese të pasurisë lidhur me ecurinë e investimit të kryer; në konsideratë edhe të rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve të parashikuara në urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm,⁹⁰ si dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁹¹, e ka bërë atë një subjekt që mund të ndikohet në veprimtarinë e tij profesionale për shkak të nevojës së tij për garantimin e përfitimeve materiale e mbrojtjes së interesave pasurorë. Një sjellje e tillë nuk përputhet me sjelljen jashtëgjyqësore që një prokuror duhet të ketë, i cili duhet të kujdeset që në sjelljen e tij profesionale si prokuror të qëndrojë i pandikuar nga interesat e tij personale financiare apo të familjes së tij, si dhe të mos pranojë favorizime nga palë të treta që mund të kenë ndikim në integritetin e paanësinë e tij. Këto rregulla sjelljeje janë parashikuar në Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005⁹² dhe Parimet e Bangalores⁹³ për sjelljen e gjyqtarit që mund të aplikohen *mutatis mutandis* për prokurorët, në të cilat parashikohet se: *“Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa privatë të tij apo të një anëtarit të familjes së tij, apo të kujt do tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”*. Bazuar në këto argumente, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, që subjekti i rivlerësimit nëpërmjet një ekspozimi/angazhimi të tillë ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.
72. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

⁸⁹ Sipas Kodit të Familjes, detyrimet e marra por edhe të ardhurat e përfituara gjatë martesës, janë pjesë e regjimit pasuror martesor të bashkësisë ligjore.

⁹⁰ Në nenin 4, pika 1, germa “ç” e këtij urdhri parashikohet: *“Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfutur interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë [...]”*.

⁹¹ Vendimi nr. 2, datë 27.02.2020, i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani.

⁹² Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm, më datë 31 maj 2005, pjesa II dhe pjesa IV, mbi sjelljen profesionale dhe private:

<https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

⁹³https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 652, datë 28.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Armand Gurakuqi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 03.11.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi